
BULETIN INFORMATIV

SHKURT 2026

AKADEMIA E SHKENCAVE
E SHQIPËRISË



**Buletin mujor i aktiviteteve të Akademisë së
Shkencave të Shqipërisë**

Shkurt, 2026

Përmbajtje

Aktivitete

Mbahet mbledhja vjetore e Asamblesë në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë	6
Delegacioni i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë merr pjesë në simpoziumin përurues të Komunitetit Ndërkombëtar të Akademive (Koinon), Athinë, Greqi	12
U mbajt takimi përurues i anëtarëve të nderit të Komunitetit Ndërkombëtar të Akademive (Koinon), Athinë, Greqi.....	13
Takim i delegacionit të Akademisë së Shkencave të kryesuar nga akad. Skënder Gjinushi me presidentin e Bordit të Drejtorëve të Akademisë së Athinës akad. Christos Zerefos dhe presidentin e Akademisë së Athinës akad. Nikiforos Diamantouros	16
11 shkurti, Dita Ndërkombëtare e Grave dhe Vajzave në Shkencë	18
Në Universitetin e Tetovës zhvilloi punimet veprimtaria shkencore dyditore “NanoBalkan Workshop 2026”	21
U zhvillua takimi informues për thirrjet për aplikimet e reja për projektet kombëtare të financuara nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, PKKZH, PTI dhe bilaterale	26
Akademia e Shkencave e Shqipërisë nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar	30
Akademia e Shkencave zhvilloi konferencën shkencore për prezantimin e projektit "Cilësia e jetës në të sëmurët me kancer”	32

Institutet dhe njësitë veprimtari

Instituti të Antropologjisë zhvilloi takimin e parë në kuadër të seminarit permanent “Përthyerje Antropologjike”	36
Instituti i Antropologjisë tryezë pune me mbledhësit e traditës në qarkun Dibër	38
Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike zhvilloi takimin për analizën e punës për vitin 2025 dhe draft-projektet për vitin 2026	40
Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike zhvilloi takimin për analizën e veprimtarive të kryera për vitin 2025 dhe planifikimet e aktiviteteve për vitin 2026	44

Pranime të reja në Akademinë e Shkencave

Prof. dr. Hubert Hasenauer u zgjodh anëtar nderi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë ..	47
Prof. dr. Burim N. Ametaj u zgjodh anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.....	49
Prof. dr. Orion Çiftja u zgjodh anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.....	52
Akad.asoc. Kozeta Sevrani fitoi titullin akademik	54
I jepet diploma e mirënjohjes “Nderi i Akademisë” prof. dr. Priamo Bollanos në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Athinë	56

Të tjera

“Shën Sofia: Kishat e Mençurisë së Tënëzoti nëpër botë”, promovohet vepra shqip që u bashkohet 15 gjuhëve të botës	59
U mbajt veprimtaria jubilarë “Profesor Neritan Ceka në 85-vjetorin e lindjes. Gjashtë dekada për arkeologjinë”	61
Akademia e Shkencave uron në datën e tij të lindjes, akademik emeritus Jani Thomain.....	65
Akademia e Shkencave uron në ditën e tij të lindjes akad. Arjan Durrësin	68
Akademia e Shkencave uron në ditën e tij të lindjes albanologun e shquar arbëresh akad. Francesco Altimarin.....	70
Akademia e Shkencave uron në datën e saj të lindjes akademiken Mimoza Hafizi	72
Prof. dr. Fjoralba Cakoni shpallet fituese e ligjërimit “Sonia Kovalevsky”	74
21 shkurt, Dita Ndërkombëtare e Gjuhës Amtare.....	76

In memoriam

Përkujtojmë sot, në përvjetorin e ndarjes nga jeta, rilindësin Jeronim de Rada.....	79
Akademia e Shkencave përkujton në ditën e saj të lindjes arkeologun dr. Hëna Spahiu.....	81

Aktivitet

Mbahet mbledhja vjetore e Asamblesë në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë



-Kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi mbajti raportin përmbledhës për veprimtarinë e Akademisë së Shkencave gjatë vitit 2025 dhe

programin dhe prioritetet e veprimtarisë për vitin 2026-

-Akad. Skënder Gjinushi: Vitin që mbyllëm Akademia forcoi profilin e statusin e saj si një qendër aktive e kërkimit shkencor në vend, si qendra më e rëndësishme e promovimit, koordinimit, nxitjes e zhvillimit të kërkimit shkencor në të gjitha fushat kryesore të shkencës e dijes, veçanërisht në shkencat albanologjike-

Mbledhja u mbajt me pjesëmarrjen e anëtarëve të Asamblesë, kryetarit të Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi dhe anëtarëve të Kryesisë, kryetarëve të komisioneve të përhershme, drejtuesve e anëtarëve të këshillave shkencorë të instituteve e të njësive të përkohshme pranë ASHSH-së.

Në raportin përmbledhës, akad. Skënder Gjinushi vuri në dukje se reformimi i ndërmarrë nga Asambleja, bazuar në ligjin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, e më pas në frymën e ligjit për shkencën, mundësoi ngritjen pranë saj të një rrjeti në zgjerim, institutesh e qendrash të përhershme e njësisht të përkohshme, të nivelit më të lartë të kërkimit shkencor në vend, duke i dhënë Akademisë së Shkencave fizionominë e modelin e shumë akademive simotra, të ngjashme me gjithë akademitë e rajonit.

Akademia, sot, nuk është më thjesht Asambleja, por një bashkim institutesh e njësisht kërkimore të ngritura me vullnetin e vizionin e kësaj Asambleje, e cila, nga ana e saj, si organi më i lartë, kujdeset e jep mbështetjen e nevojshme për të garantuar nivelin shkencor të tyre.





Më tej, akad. Gjinushi vuri në dukje se rezultatet e këtij viti e të katër viteve të mëparshme tregojnë se reformimi i ASHSH-së është bërë me shpenzime minimale.

Pasi vlerësoi realizimin e projekteve të programuara për vitin 2025 si sfidën kryesore me angazhimin e çdo njësie pranë ASHSH-së, akad. Gjinushi theksoi se Akademia e Shkencave, gjatë këtij viti ka mbështetur dhe një numër të konsiderueshëm projektesh që janë aplikuar pranë Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, AKKSHI.

Përmbledhtas rezulton se, projektet në tërësi kanë ecur sipas parashikimeve.

Kryetari i Akademisë theksoi se për t'u përshëndetur është dalja online e maketit të "Fjalorit të madh të gjuhës shqipe" me 125 000 fjalë e frazeologji, i cili është mirëpritur e vlerësuar nga mbarë opinionin publik, përdoruesit e shumtë dhe specialistët e fushës, çka shprehet si nga reagimet falënderuese e çmuese, ashtu dhe nga interesi i madh i shfaqur. Deri më tani, në 45 ditë, ka pasur rreth 5 milion klikime. Ai theksoi se "Fjalori i madh i gjuhës shqipe" do të jetë në përmirësim e pasurim të vazhdueshëm e ky është edhe roli i Qendrës së Botimeve Enciklopedike e Albanologjike e sektorit përkatës të saj.

Akad. Gjinushi u shpreh se viti 2025 forcoi statusin e ASHSH-së si qendra kryesore e organizimit të veprimtarive kryesore shkencore në vend. Gjatë këtij viti u kryen rreth 135 veprimtari si: kongrese, konferenca, simpoziume, workshop-e, shkolla verore, leksione të hapura etj., të shtrira në të gjitha fushat kryesore të shkencës e dijes, të nivelit kombëtar e ndërkombëtar, në bashkëpunim me institucionet e ndryshme arsimore e shkencore në vend.



Rritja e projekteve dhe veprimtarive kanë ndikuar në rritjen e botimeve veçanërisht të artikujve shkencor në revista jashtë vendit, të indeksuara, në mënyrë të veçantë prej njësive të reja.

Ai vuri në dukje drejtimet kryesore të punës së Akademisë së Shkencave për vitin 2026, ku së pari theksoi angazhimin për fillimin e riorganizimit të njësive të albanologjisë në zbatim të reformës për sistemin e kërkimit shkencor, duke u dhënë atyre e punonjësve kërkimorë statusin e duhur, në frymën e ligjit për shkencën e në përputhje me ligjin e statutin e ASHSH-së.

Për këtë, akad. Gjinushi u shpreh se Asamblesë i kërkohet miratimi i ndryshimeve në statut, të cilat e vendosin sistemin e kategorizimit të punonjësve kërkimorë-shkencorë në nivelin e të ngjashmëve në Europë.

Duke theksuar se dhënia e kategorizimeve nga vetë institucionet sipas kriterëve të vendosura po prej tyre, komform modeleve të konsoliduara, rrit autonominë e tyre, e cila, nuk matet me deklarime, por me veprime e vendimmarrje konkrete.

Sfida jonë e dytë për 2026-n është ngritja e Qendrës Nanoalb në nivelin e një qendre rajonale elitare, çka, në sajë të punës disavjeçare të qendrës ekzistuese e mbështetjes nga kjo Asamble, është parashikuar tashmë në Strategjinë S3, zbatimi i së cilës financohet e monitorohet nga BE-ja si dhe ngritja e QKBGJ-së në nivelin e një bashkimi institutesh të shkencave të jetës. U theksua se detyra e Asamblesë është t'i çojë

deri në fund këto ndërmarrje me efekt të pakrahasueshëm për kërkimin shkencor në Shqipëri, në të gjitha fushat natyrore-teknike.



Në përfundim të parashtrimit të tij, akad. Gjinushi theksoi se angazhimet kryesore, të Akademisë ndikojnë në drejtim të arritjes së objektivit parësor europian, rritjes së financimeve në shkencë, më së pari në nivelin e 1% të PBB-së; ato bëjnë që ky financim të arrihet jo formalisht, por me investime në drejtimin e duhur e me efektivitetin e dëshiruar.

Gjatë mbledhjes u paraqit raporti financiar nga kancelari z. Ruzhdi Kuçi, e më pas u vijua me prezantimin e programit dhe prioriteteve të veprimtarisë për vitin 2026 nga sekretarja shkencore akad. Anila Hoda.

Në përfundim të diskutimeve u bë miratimi i raporteve për 2025-n dhe programit për 2026-n, përfshirë shpërndarjen e buxhetit. Asambleja miratoi dhe ndryshimet e plotësimet në statut, si dhe zgjodhi dy anëtarë të jashtëm e një anëtar nderi të ASHSH-së e miratoi një avancim në titulli sipas rendit të ditës.



Delegacioni i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë merr pjesë në simpoziumin përurues të Komunitetit Ndërkombëtar të Akademive (Koinon), Athinë, Greqi

Sot nisën punimet dyditore të simpoziumit përurues të Komunitetit Ndërkombëtar të Akademive (Koinon), Athinë, Greqi.

Në këtë veprimtari të nivelit të lartë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë përfaqësohet nga kryetari akad. Skënder Gjinushi, zëvendëskryetari akad. Vasil S. Tole dhe akad. Anastas Angjeli.

Përgjatë punimeve të simpoziumit përurues dyditor më 9 dhe 10 shkurt 2026, janë bërë së bashku mbi 38 akademi nga e gjithë bota të cilësuar anëtare nderi dhe 3 akademi të tjera me statusin e vëzhguesit.

Komuniteti Ndërkombëtar i Akademive, (International Community (Koinon) of Academies) është një organizatë ndërkombëtare që bashkon akademi shkencash nga vende të ndryshme, me qëllim nxitjen e bashkëpunimit akademik dhe shkencor.

Në këtë veprimtari, e cila përkon me 100-vjetorin e Akademisë së Athinës, ASHSH-ja është në cilësinë e saj si anëtare nderi në Koinon, me përfaqësues akademik Anastas Angjelin.



U mbajt takimi përurues i anëtarëve të nderit të Komunitetit Ndërkombëtar të Akademive (Koinon), Athinë, Greqi Athinë, Greqi



Në kuadër të simpoziumit ndërkombëtar për themelimin e Komunitetit Ndërkombëtar të Akademive, KOINON, në fund të ditës së dytë u mbajt takimi përurues i Anëtarëve të Nderit që përfaqësojnë akademi shkencash nga 38 vende të botës, ndër to edhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë e përfaqësuar nga akademik Anastas Angjeli.

Vendet pjesëmarrëse janë:

1. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Shqipëri
2. Akademia Kombëtare e Shkencave, Kosta Rika
3. Akademia Kombëtare dei Lincei, Itali
4. Akademia e Athinës, Greqi
5. Akademia e Shkencave e Afrikës së Jugut, Afrikë e Jugut
6. Akademia e Kërkimit Shkencor dhe Teknologjisë, Egjipt
7. Akademia Amerikane e Arteve dhe Shkencave, SHBA
8. Akademia Arabe e Shkencës, Teknologjisë dhe Transportit Detar, Egjipt
9. Akademia Austriake e Shkencave, Austri
10. Akademia Kombëtare e Shkencave e Azerbajxhanit, Azerbajxhan

-
11. Akademia Bullgare e Shkencave, Bullgari
 12. Akademia Kineze e Shkencave Shoqërore (CASS), Kinë
 13. Akademia Kongoleze e Shkencave, Republika Demokratike e Kongos
 14. Akademia Kroate e Shkencave dhe Arteve, Kroaci
 15. Akademia e Shkencave, Letërsisë dhe Arteve e Qipros, Qipro
 16. Akademia Estoneze e Shkencave, Estoni
 17. Akademia Etiopiane e Shkencave, Etiopi
 18. Akademia Gjeorgjiane e Shkencave Natyrore, Gjeorgji
 19. Akademia Kombëtare e Shkencave e Gjeorgjisë, Gjeorgji
 20. Akademia Hungareze e Shkencave, Hungari
 21. Akademia Indiane e Shkencave, Indi
 22. Akademia Kombëtare Indiane e Shkencave, Indi
 23. Akademia Izraelite e Shkencave dhe e Shkencave Humane, Izrael
 24. Akademia Kombëtare e Shkencave e Kenias, Kenia
 25. Akademia Malazeze e Shkencave dhe Arteve, Mali i Zi
 26. Akademia Kombëtare e Shkencave Ekzakte, Fizike dhe Natyrore, Argjentinë
 27. Akademia Kombëtare e Mjekësisë e Buenos Airesit, Argjentinë
 28. Akademia Kombëtare e Shkencave dhe Teknikave e Senegalit, Senegal
 29. Akademia Kombëtare e Shkencave e Hondurasit, Honduras
 30. Akademia Kombëtare e Shkencave e Sri Lankës, Sri Lanka
 31. Akademia Kombëtare e Shkencave e Republikës së Koresë, Kore e Jugut
 32. Akademia Norvegjeze e Shkencës dhe e Letërsisë, Norvegji
 33. Akademia Papnore e Shkencave, Qyteti i Vatikanit
 34. Akademia Mbretërore e Shkencave, Letërsisë dhe Arteve të Bukura e Belgjikës, Belgjikë
 35. Akademia Mbretërore Flamande e Belgjikës për Shkencë dhe Arte
 36. Akademia Mbretërore e Kanadasë, Kanada
 37. Akademia Serbe e Shkencave dhe Arteve, Serbi
 38. Akademia Turke e Shkencave, Turqi

Akademi vëzhguese

1. Akademia Britanike, Mbretëria e Bashkuar
2. Akademia Kombëtare Gjermane e Shkencave "Leopoldina", Gjermani
3. Shoqëria Mbretërore, Mbretëria e Bashkuar

Mbledhja u mbajt me synim inagurimin zyrtar të trupës së Anëtarëve të Nderit, si dhe krijimin e një hapësire për shkëmbim mendimesh mbi rolin dhe veprimtaritë e ardhshme të Koinon, Athinë, Greqi.

KOINON synon të promovojë parimet e Akademisë së Platonit, duke i shërbyer forcimit të rolit të shkencës dhe të institucioneve akademike në shoqërinë bashkëkohore

përmes simpoziumeve ndërkombëtare, ngjarjeve shkencore dhe kulturore, çmimeve globale dhe aktiviteteve të përbashkëta me institucione akademike në mbarë botën.



**Takim i delegacionit të Akademisë së Shkencave të kryesuar nga akad.
Skënder Gjinushi me presidentin e Bordit të Drejtorëve të Akademisë së
Athinës akad. Christos Zerefos dhe presidentin e Akademisë së Athinës akad.
Nikiforos Diamantouros**



Gjatë vizitës zyrtare të delegacionit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në Athinë të kryesuar nga kryetari akademik Skënder Gjinushi, që u organizua në kuadër të krijimit të bashkësisë akademike ndërkombëtare KOINON, u zhvilluan takime dypalëshe me drejtuesit më të lartë të akademisë greke.


Takimi u mbajt në praninë e akademik Christos Zerefos, president i Bordit të Drejtorëve të Akademisë së Athinës dhe akademik Nikiforos Diamantouros, presidenti i Akademisë së Athinës, të cilët vlerësuan pjesëmarrjen e Shqipërisë në “anëtar nderi” themelues në këtë bashkësi vlerash.

Në takimin zyrtar me prof. Antonios Rengakos, sekretar i përgjithshëm i Akademisë së Athinës, u theksua nevoja e përbashkët për të pasur një bashkëpunim të institucionalizuar, kjo përmes nënshkrimit të një marrëveshjeje, që ishte e para pas viteve 1990, me tekstin dhe përmbajtjen e së cilës palët ranë dakord.

Sekretari Rengakos theksoi disa fusha të mundshme bashkëpunimi, si arkeologjia e historia, gjuhësia, antropologjia, arti, dhe nanoteknologjia, biomjekësia dhe ekonomia etj. Marrëveshja do të parashikojë kontakte e veprimtari të përbashkëta mes institucioneve respektive të dy akademive tona.



Në takime morën pjesë zv. kryetari i ASHSH, akademik Vasil S. Tole, akademik Anastas Angjeli, kryetar i Komisionit të përhershëm të ekonomisë pranë ASHSH dhe përfaqësuesi zyrtar i ASHSH-së në bashkësinë akademike ndërkombëtare KOINON, si dhe znj. Luella Hajdaraga, ambasadore e Republikës së Shqipërisë në Greqi. Nënshkrimi i marrëveshjes do të bëhet së shpejti.



11 shkurti, Dita Ndërkombëtare e Grave dhe Vajzave në Shkencë



Veprimtaria u zhvillua sot, më 11 shkurt 2026, në kuadër të Ditës Botërore të Grave dhe Vajzave në Shkencë.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë është bashkorganizatore e forumit akademik, së bashku me Universitetin Barleti, Institutin Shqiptar të Sociologjisë dhe Shoqatën Sociologjike Shqiptare.

Forumi u organizua si pjesë e ciklit të forumeve akademike Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut, Mal i Zi dhe Diasporë, ku morën pjesë personalitete gra që drejtojnë sot në nivelet më të larta institucionet e arsimit të lartë publik dhe jopublik në Shqipëri, studiuese të zëshme në fusha të ndryshme të shkencës.

Veprimtaria u moderua nga Kristi Ziçishti, drejtor e Sektorit të Sipërmarrjes dhe Inovacionit, Universiteti Barleti Tiranë.

Përshëndetën veprimtarinë prof. dr. Aleksandër Xhuvani, zv.rektor për Kërkim dhe Zhvillim në Universitetin Barleti; akad. Anila Hoda, sekretare shkencore e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe dr. Klodiana Spahiu, nënkryetare e Kuvendit të Shqipërisë, të cilët u shprehën për mbështetjen e vazhdueshme të pjesëmarrjes së grave

në komunitetet e shkencës dhe të teknologjisë, duke forcuar, gjithashtu, rolin e tyre drejtues në projekte dhe kërkime shkencore.

Seanca plenare u çel nga znj. Zyhra Bedalli, drejtore e Burimeve Njerëzore e Universitetit “Aleksandër Xhuvani” të Elbasanit, e cila paraqiti kumtesën e prof. dr. Elvira Fetahut, rektores së këtij universiteti, me temën “Raportet gjinore në institucionet e arsimit të lartë: domethënia dhe përgjegjësitë. Rasti i Universitetit të Elbasanit”.

Prof. dr. Enika Abazi, Drejtore e Qendrës së Kërkimit Shkencor dhe Koordinimit të Projekteve në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, mbajti kumtesën “Avancimi i barazisë gjinore nëpërmjet pjesëmarrjes së grave në kërkimin shkencor dhe projektet madhore kombëtare”.



Prof. asoc. dr. Artemisi Shehu, zëvendësdekane e Fakultetit të Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës dhe prof. asoc. dr. Elsa Skënderi Rakiplari, Universiteti i Tiranës (fituese e Çmimit Elena Gjika për gratë dhe vajzat në shkencë, 2025) trajtuan disa nga përvojat më të rëndësishme dhe sfidat e grave dhe vajzave në shkencë.

Në fund të seancës plenare u zhvillua ceremonia e ndarjes së çmimit “Elena Gjika – Dora D’Istria”.

Prof. dr. Lekë Sokoli, sekretar shkencor i Komisionit të Vlerësimit të Kontributeve Akademike (KVKA) (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut, Mal i Zi dhe Diasporë) dhe

drejtues i Instituti Shqiptar të Sociologjisë - Shoqata Sociologjike Shqiptare, deklaroi vendimin që fituesja e çmimit “Elena Gjika – Dora D’Istria” për Gratë dhe Vajzat në Shkencë, 2026 është pedagogia dhe studiuesja dr. Jorida Rustemi, në mirënjohje të kontributit të saj të spikatur në fushën akademike dhe kërkimin shkencor. Ky çmim synon të promovojë rolin e grave në shkencë, të inkurajojë përfaqësimin e tyre në kërkim dhe të forcojë kulturën e meritokracisë në institucionet akademi.

Kjo datë, shënon edhe 10-vjetorin e krenimit të Ditës Ndërkombëtare të Grave dhe Vajzave në Shkencë, të shpallur nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së.



Në Universitetin e Tetovës zhvilloi punimet veprimtaria shkencore dyditore “NanoBalkan Workshop 2026”



- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, e përfaqësuar nga akad. Arben Merkoçi, është iniciatore dhe bashkorganizatore e veprimtarisë-

Veprimtaria u mbajt më 16 shkurt 2026 në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Tetovës.

“NanoBalkan Workshop 2026” përfaqëson një hap të rëndësishëm në forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e nanoteknologjisë, si një disiplinë që po zë një vend qendror në zhvillimin e shkencave natyrore dhe aplikimeve të avancuara teknologjike.

Iniciator dhe kontribuues i këtij aktiviteti është akad. Arben Merkoçi (Akademia e Shkencave e Shqipërisë), si dhe stafi lokal i NanoBalkan: prof.dr. Arianit Reka, prof. dr. Ahmed Jashari; prof. dr. Bashkim Ziberi. Akademia e Shkencave e Shqipërisë u përfaqësua me 11 pjesëmarrës: prof. dr. Majlinda Vasjari dhe prof. dr. Kledi Xhaxhiu (ASHSH, Universiteti i Tiranës), bashkëkordinatorët e NanoAlb; prof. dr. Besnik Baraj, prof. asoc. Merita Xhetani etj.



Në hapjen solemne të këtij aktiviteti ishin të pranishëm edhe Rektori i Universitetit të Tetovës prof. dr. Jusuf Zejneli, dhe dekani i FSHMN-së, prof. dr. Florim Idrizi.

Rektori i Universitetit të Tetovës prof. dr. Jusuf Zejneli shprehu mirënjohjen për të gjithë organizatorët që kontribuan në realizimin e këtij workshop-i dhe theksoi se vetë fakti që “NanoBalkan” zhvillohet në UT, me përfaqësues, shkencëtarë e studiues nga shumë vende të ndryshme, paraqet sfidë, përgjegjësi dhe përkushtim. “Sot së bashku me ju, zotohemi se në vazhdimësi do të vendosim rrënjët e “NanoBalkan” në Universitetin e Tetovës dhe jam i bindur se për një periudhë të shpejtë, bashkërisht do arrijmë të vendosim një laborator të ri, enkas për sferën e nanoteknologjisë, me qëllim që universiteti ynë t’u mundësojë studiuesve dhe studentëve që të realizojnë projektet dhe analizat”. -tha prof. dr. Zejneli.

Dekani i Fakultetit të Shkencave Matematike - Natyrore të Universitetit të Tetovës prof. dr. Florim Idrizi u shpreh se nanoteknologjia kontribuon në krijimin e materialeve me veti të reja, në zhvillimin e sistemeve inteligjente, si dhe në ofrimin e zgjidhjeve inovative në mjekësi, energji, elektronikë dhe mbrojtjen e mjedisit. Sipas dekanit, përmes këtij workshop-i krijohet një hapësirë e rëndësishme akademike për prezantimin e rezultateve kërkimore, shkëmbimin e përvojave, diskutimin e metodologjive bashkëkohore dhe identifikimin e drejtimeve të reja të kërkimit shkencor.



Akad. Arben Merkoçi u shprehu falënderimet pjesëmarrësve dhe Universitetit të Tetovës për mikpritjen. Ai theksoi se Workshopi nxori në pah arritjet kërkimore të vitit 2025, prezantoi progresin e Projekteve Ignite dhe nxiti ide të reja për bashkëpunime të reja në të gjithë rajonin dhe më gjerë. Me mbështetjen e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Projektit SUSNANO, si dhe me organizimin e Universitetit të Tetovës e grupeve të tij kërkimore NanoBalkan, ky aktivitet shërben si një forum për të reflektuar mbi progresin shkencor dhe për të formësuar partneritetet e ardhshme. Ai tha se nanoteknologjia është një fushë shumë e hapur, shumë transversale, ku marrin pjesë ekspertiza nga më të ndryshmet, duke filluar nga kimia, biologjia, fusha e shkencave kimike, fusha e materialeve, e inxhinierisë, informatika apo inteligjenca artificiale e më gjerë dhe është një fushë e cila u jep mundësi kërkuesve shkencorë të inxhinierisë të punojnë dhe të bashkëpunojnë, pasi në këtë fushë, bashkëpunimi është shumë i rëndësishëm. Akad. Merkoçi shprehu bindjen se ky takim do t'u shërbejë bashkëpunimeve të mëtejshme midis grupeve kërkimore-shkencore, njohjes së infrastrukturave dhe mundësive që kanë kolegët dhe studiuesit në Universitetin e Tetovës.

Në ditën e dytë të veprimtarisë shkencore u bënë vizita në laboratorët e grupeve NanoAlb.

Veprimtaria vijoi me ceremoninë e 31-vjetorit të ligjëratave të para të Universitetit të

Tetovës, ku akad. Arben Merkoçi ishte i ftuar të mbante një fjalim në lidhje me eksperiencën e tij në kërkimin shkencor, si dhe në krijimin dhe funksionimin e NanoAlb të mbështetur nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

Kjo veprimtari do të kontribuojë në ndërtimin e rrjeteve të qëndrueshme të bashkëpunimit, të cilat janë thelbësore për realizimin e projekteve të përbashkëta, aplikimin në programe ndërkombëtare kërkimore dhe transferimin e njohurive drejt industrisë dhe shoqërisë.

Lexo linkun: <https://akad.gov.al/ne-universitetin-e-tetoves-zhvilloi.../>





U zhvillua takimi informues për thirrjet për aplikimet e reja për projektet kombëtare të financuara nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, PKKZH, PTI dhe bilaterale



Akademia e Shkencave e Shqipërisë, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), organizoi veprimtarinë me temën “Ditë informimi në lidhje me thirrjet për aplikimet e reja për Projektet e Kërkimit dhe Zhvillimit (PKKZH) për vitin 2026”.

Veprimtaria u mbajt me synimin që të gjithë drejtuesit e seksioneve dhe të qendrave kërkimore-shkencore të ASHSH-së, si dhe kërkuesit shkencorë të pranishëm në këtë takim të informohen më në thellësi për mënyrën dhe kushtet e aplikimit në PKKZH dhe Programet Kombëtare të Teknologjisë dhe të Inovacionit (PTI).

Takimin e hapi prof. dr. Enika Abazi, drejtorja e Qendrës së Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Projekteve në Akademinë e Shkencave. Ajo bëri një përmbledhje të bashkëpunimeve të derisotme ndërmjet Akademisë dhe AKKSHI-t. Projektet e financuara nga AKKSHI synojnë mbështetjen e kërkimit shkencor cilësor në fushat parësore kombëtare, si: biodiversiteti dhe mjedisi; bujqësia, ushqimi dhe bioteknologjia;

shëndetësia dhe shkencat mjekësore; sistemet dhe teknologjitë e informacionit; shkencat sociale dhe albanologjike; uji dhe energjia.



Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi shprehu falënderimet për fondet e investuara nga AKKSHI për projektet shkencore dhe për punën e bërë për seleksionimin dhe administrimin e tyre. Ai u shpreh se Akademia e Shkencave do të jetë nxitësja, organizuesja kryesore për të ideuar dhe për të ndërmarrë projekte të caktuara, me synimin për të nxitur kërkimin shkencor në Shqipëri. Arsyeja që i vlerësoj këto projekte është se lidhen me përparësitë e Akademisë së Shkencave për ngritjen dhe funksionimin e qendrave të kërkimit shkencor, - tha akad. Gjinushi.

Më tej, kryetari i Akademisë së Shkencave tha se ngritja e qendrave të kërkimit shkencor dhe realizimi i projekteve është në rrugën e duhur. Vetë Akademia e Shkencave ka zgjeruar e ristrukturuar strukturat pranë saj, e cila ka si synim kryesor kthimin e njësive që funksionojnë aktualisht në qendra elitare rajonale të kërkimit shkencor. Akad. Gjinushi theksoi se bashkëpunimi në projekte është i domosdoshëm për zbatimin e Ligjit për Shkencën, si dhe për nevojën e bashkëpunimit me institucionet qendrore, ku akademikët janë drejtues të projekteve dhe luajnë rolin e nxitësit e të mbështetësit. Veçanërisht në shkollat e larta grupet drejtuese të projekteve janë shumëpalëshe.

Akad. Gjinushi shprehu, ndër të tjera, mirënjohjen për mbështetjen që jep qeveria për zhvillimin e projekteve të Akademisë së Shkencave dhe theksoi se me zgjerimin e

bashkëpunimeve, rritjen e nivelit të kërkimit shkencor dhe projektet e mirorganizuara do ta kapërcejmë handikapin e krijuar sipas ligjit për arsimin e lartë.



Më pas foli drejtoresha e përgjithshme e AKKSHI-t, znj. Mirela Muça. Ajo vlerësoi rëndësinë e bashkëpunimit me ASHSH-në, që do të ndikojë në realizimin e projekteve edhe më afatgjata. Më tej ajo vuri në dukje përparësitë e reja në thirrjet e hapura. Tashmë, përveç tri thirrjeve për projekte në nivel kombëtar, në kuadër të marrëveshjeve dhe të protokolleve është hapur edhe bashkëpunimi bilateral për zhvillim me Turqinë në fushat e kërkimit shkencor dhe teknologjik, në kuadër të të cilit nuk financohet vetëm mobiliteti, por edhe projekte të përbashkëta në fusha të ndryshme të shkencës. Znj. Muça vuri në dukje edhe punën që po bëhet për mundësimin e pjesëmarrjen e ASHSH-së në projektet e infrastrukturës dhe projektet e bashkëpunimit me biznesin.

Në vijim të takimit informues, drejtoresha e Drejtorisë së Programeve Kombëtare dr. Marsela Robo tha se programet kombëtare janë të hapura dhe kanë një bazë shumë të gjerë bashkëpunuese. Zgjerimi i bashkëpunimeve duhet të kthehet në standard. Me tej dr. Robo bëri një pasqyrë të thirrjeve të hapura, duke cilësuar se PKKZH-ja përfaqëson një mundësi konkrete për kërkuesit shkencorë, universitetet dhe institucionet kërkimore për të zhvilluar projekte me ndikim dhe në avancimin e dijes, të inovacionit dhe të zhvillimit të qëndrueshëm në Shqipëri. Ajo falënderoi kërkuesit shkencorë të Akademisë së Shkencave për botimin e artikujve në revista që kanë ndikim në Scopus, si një tregues i mirë i arritjeve në kërkimin shkencor. Gjithashtu, ajo iu përgjigj edhe një sërë pyetjeve të bëra nga pjesëmarrësit në këtë ditë informimi dhe sqaroi disa probleme që hasen gjatë fazave të projektit, duke filluar me aplikimin dhe deri te raportimi i fundit.



Akademia e Shkencave e Shqipërisë nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar



Marrëveshja e bashkëpunimit mes Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASHSH) dhe Urdhrit Profesional të Mjekut Veterinar të Shqipërisë (UPMVSH) u nënshkrua sot me rastin e 98-vjetorit të mjekësisë veterinare në vendin tonë.

Marrëveshja u nënshkrua nga kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi dhe presidenti i Urdhrit Profesional të Mjekut Veterinar, zoti Ervin Resuli.

Kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi e vlerësoi nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje si një dëshmi të vullnetit të përbashkët për të lidhur më ngushtë kërkimin shkencor, formimin profesional dhe praktikën veterinare.

Akad. Gjinushi më tej u shpreh se Akademia e Shkencave e ka për mision që të luajë rolin e një qendre koordinimi, për promovimin e kërkimit shkencor në tërësi dhe këtu shkencat e veterinarisë zënë një vend të veçantë. Ai theksoi se në ASHSH funksionon, krahas 11 komisioneve të përhershme, një komision që mbulon këtë fushë që është komisioni që i kushtohet bujqësisë, biologjisë dhe veterinarisë.



Akademia e Shkencave në kuadër të reformimit të sistemit të kërkimit ka si prioritet ngritjen e një qendre të shkencave të jetës sipas konceptit “Një shëndet” e cila do të forconte kërkimin edhe në shkencat veterinare.

Duke falenderuar për ftesën, akad. Gjinushi shprehu vullnetin e Akademisë për të bashkëpunuar në konkretizimin e marrëveshjes si për ngritjen e qendrës, ashtu edhe për mbështetjen e reformës së ndërmarrë nga UBT, për një përgatitje në nivel evropian të specialistëve të rinj e posaçërisht të mjekëve veterinerë.

Akademia e Shkencave zhvilloi konferencën shkencore për prezantimin e projektit "Cilësia e jetës në të sëmurët me kancer"



Veprimtaria shkencore u mbajt më 26 shkurt 2026 me organizimin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë nën përgjegjësinë e Komisionit të përhershëm të mjekësisë pranë saj dhe në bashkëpunim me Universitetin e Mjekësisë, Fakultetin e Mjekësisë, Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (Shërbimi i Onkologjisë) dhe Institutin e Shëndetit Publik.

Projekti "Cilësia e jetës në të sëmurët me kancer - post diagnozë dhe trajtim - vlerësimi i parë në Shqipëri" u mbështet nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI).

Konferenca u moderua nga akad. Genc Sulçebe, kryetar i Komisionit të përhershëm të mjekësisë (ASHSH) dhe prof. asoc. Albana Fico.

Në fjalën e hapjes së konferencës, prof. asoc. Fico vlerësoi rezultatet e punës dyvjeçare, si dhe bashkëpunëtorët e mbështetësit të projektit. Ajo u shpreh se sëmundja tumorale është një sfidë e madhe kudo në botë, ku më pak e vlerësuar mbetet sfida se si preket cilësia e jetës postdiagnozë. Sipas saj, ky studim hap rrugën për një trajtim më të plotë të të sëmurëve dhe është një angazhim serioz në veprimtarinë e këtij procesi.

Në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave, pjesëmarrësit dhe organizatorët i përshëndeti sekretarja shkencore e Akademisë së Shkencave, akad. Anila Hoda, e cila vuri në dukje strategjitë e drejtimit të punës kërkimore. Ajo tha se Akademia e Shkencave e Shqipërisë e koncepton rolin e saj si një urë midis kërkimit shkencor,

praktikës klinike dhe politikave shëndetësore duke vendosur gjithmonë në qendër njeriun dhe mirëqenien e tij fizike, psikologjike dhe sociale. Akademia e Shkencave e Shqipërisë sipas sekretares shkencore është e përkushtuar ndaj qasjes multidisiplinare duke nxitur ndërthurjen e dijes në fusha të ndryshme të shkencës.



Zëvendësministrja e Arsimit, znj. Armela Baka, vlerësoi punimet e kësaj konference si një studim shkencor që shkon përtej një takimi akademik, si një rezultat ndërinstitutional, duke u bërë një shembull i shkëlqyer për mundësitë e zhvillimit të kërkimi shkencor në vendin tonë. Më tej ajo u shpreh edhe për mbështetjen e vazhdueshme të MA-së në kërkimet shkencore.

Drejtoresha e QSUNT znj. Anxhela Papparizo theksoi se kjo është një veprimtari shkencore që sjell për herë të parë në Shqipëri një vlerësim të strukturuar mbi cilësinë e jetës tek pacientët me kancer. Ajo theksoi se programi pasqyron një gamë të gjerë temash, nga prirjet e kancerit në Shqipëri, te dezinformimi në epokën digjitale, rëndësia e stadit të paraqitjes së tumorit, trajtimi psikoemocional dhe roli kyç i parandalimit përmes vaksinimit ndaj HPV-së.

Znj. Mirela Muço, drejtoresha e përgjithshme e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), si institucion financues i projektit kërkimor ‘Cilësia e jetës në të sëmurët me kancer në Shqipëri’-post diagnozë dhe trajtim-vlerësimi i parë në Shqipëri” e vuri theksin në investimin e qëndrueshëm në kërkimin

shkencor cilësor, në teknologjitë inovative dhe bashkëpunimin institucional duke shkuar drejt zgjidhjeve konkrete në diagnostikimin e hershëm, si dhe diagnostikim e të personalizuar e cilësinë e jetës së pacientëve.



Në fokus të prezantimeve të projektit ishin faktorët që kushtëzojnë shfaqjen e kancerit në Shqipëri, trajtimi i të sëmurëve me kancer dhe parandalimi i sëmundjes, vështuar në perspektivën e arritjeve dhe përmirësimeve në trajtimet tona klinike.



Institutet dhe njësitë veprimtari

Instituti të Antropologjisë zhvilloi takimin e parë në kuadër të seminarit permanent “Përthyerje Antropologjike”



Me datë 20 shkurt 2026, u zhvillua takimi i parë në kuadër të seminarit permanent “Përthyerje Antropologjike” për vitin 2026.


Konceptuar si një aktivitet i përhershëm i Institutit të Antropologjisë ky seminar ka si qëllim zhvillimin e një serie takimesh të rregullta, ku prezantohen monografi, studime, projekte kërkimore, në sferën e kërkimit etnografik dhe disiplinave të tjera në shkencat sociale dhe pikëtakimet e tyre me antropologjinë social kulturore.

Në takimin e parë të këtij viti u prezantua/diskutua Monografia: “NJë Antropologji mbi Varfërinë dhe të Skajuarit, Rasti i Romëve në Shqipëri” me autor Dr. Ervin Kaçi.

Kjo monografi përfaqëson një perspektivë të leximeve mbi modernitetin shqiptar, pakicat dhe mekanizmat e prodhimit të skajimit social. Duke ndërthurur analizën historiografike, kërkimin etnografik dhe reflektimin teorik mbi raportin agjenci-strukturë, vepra propozon një “arkeologji” të varfërisë rome në kontekste të ndryshme politike, nga shtetformimi dhe socializmi shtetëror, deri në tranzicionin post-socialist.

Libri e trajton varfërinë dhe skajimin social si konstrukt historik dhe marrëdhënie pushteti, të ndërthurur me taksonomi shtetërore, përfytyrime shoqërore dhe kufij simbolikë të përkatësisë. Në këtë kuptim, larg të qënurit “tjetri ekzotik”, romët shfaqen

si lakmues kritik në diskutimin mbi dinjitetin njerëzor, përjashtimin dhe drejtësinë sociale, duke u ofruar studiuesve dhe publikut një perspektivë të thelluar mbi një nga çështjet më të ndieshme të shoqërisë sonë.



Instituti i Antropologjisë tryezë pune me mbledhësit e traditës në qarkun Dibër



Ditën e premte, 27 shkurt 2026, në mjediset e Institutit të Antropologjisë, në sallën “Rrok Zojzi”, u mbajt tryeza e punës me mbledhësit e traditës së qarkut Dibër. Tryeza u organizua e u bashkërendua nga Laboratori i Antropologjisë Gjuhësore, në kuadrin e Projektit Shkencor Kombëtar “Thirre vendin tënd! Hapësira si kujtesë”.

Në tryezë morën pjesë 15 mbledhës tradite, mes tyre edhe 3 mësuese nga shkolla 9-vjeçare “Selim Alliu”, Peshkopi. Mësueset Sonila Dani, Valbona Zeqja dhe Elda Shehi sollën në tryezë edhe punimin e nxënësve të shkollës së tyre, me vjelje etnografike e gjuhësore në terren të disa fshatrave të Dibrës, punim të cilin e kanë botuar në formën e një libri të titulluar “Kur toka flet me emra”. Ky projekt shkollor, i nxitur dhe i


koordinuar nga Laboratori i Antropologjisë së Gjuhës, është tashmë gjysmëfinalist në Konkursin Kombëtar të Shkollave 9-vjeçare të Shqipërisë.

Mbledhësit e pranishëm në tryezë, si Haki Përnezha, Luan Cermenja, Zaim Sefa, Hysen Uka, Shaqir Skarra, Kadri Dauti, Agim Reçi, Selman Mëziu, Njazi Vranizi, Shaqir Shaqja etj, mbulonin pak a shumë krejt shtrirjen etnografike të Dibrës (pa Bulqizën në të cilën është planifikuar edhe një tjetër ekspeditë), pra vinin nga zona si Çidhna, Muhurri, Selishta, Reçi, Shumbati, Golloborda, Ujemuja, Zall-Dardha, Staraveci, Luznia etj.

Kjo tryezë thelloi edhe më tej kapilarizimin e punës në terren, koordinoi kriteret e mbledhjeve dhe të regjistrimit, sinkronizoi përpjekjet për krijimin e një arkivi sa më të plotë multidisiplinor të Qarkut Dibër.

Tryezës iu bashkua me kontributin e saj edhe Elsa Bitri, vajzë dibrane e bijë mbledhësi tradite, aktualisht punonjëse e Sektorit të Bibliografisë pranë Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë.

Tryeza që pjesë e Kalendarit të punës së Laboratorit të Antropologjisë Gjuhësore, kalendar ky që parashikon edhe tryeza të tjera me mbledhës, gjithnjë në mjediset e Institutit të Antropologjisë.



Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike zhvilloi takimin për analizën e punës për vitin 2025 dhe draft-projektet për vitin 2026



Takimi u mbajt në datën 10 shkurt 2026, në praninë e sekretares shkencore të Akademisë së Shkencave, akad. Anila Hoda; kryetarit të Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, akad. Gëzim Hoxha, dhe drejtuesve të instituteve, qendrave, komisioneve dhe njësive kërkimore të ASHSH-së.

Fillimisht, akad. Gëzim Hoxha paraqiti raportin vjetor të punës kërkimore shkencore të SSHSHA-së të realizuar në bashkëpunim me komisionet, qendrat dhe njësitë kërkimore-shkencore të ASHSH-së. Ai tha se viti 2025 ka shënuar një hap të rëndësishëm përpara për integrimin e instituteve të albanologjisë në sistemin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Më tej, foli për punën e mirë në hartimin e strategjive afatshkurtra dhe afatgjata të këtyre instituteve, si në fushën e kërkimit shkencor ashtu dhe në drejtim të konsolidimit dhe rifreskimit të stafit kërkimor-shkencor dhe atij teknik.



SSHSHA ka mbajtur gjatë vitit 54 aktivitete, 20 ndërkombëtare dhe 34 kombëtare, me pjesëmarrjen e 632 referuesve. Po ashtu kanë qenë të shpeshta bashkëpunimet, ku përfshihen 74 institucione kërkimore shkencore jashtë ASHSH-së, si institucione, organizata qeveritare apo individë të shquar në fushën e shkencës, kulturës e të artit.

Akad. Hoxha vlerësoi disa nga veprimtaritë me impakt më të madh si: Konferenca ndërkombëtare me temën “Roli i elitave në mijëvjeçarin e parë p.e.s. midis Europës Qendrore dhe Ballkanit Jugor – me rastin studimor të “Kalorësit të Babunjës”, që u organizua në bashkëpunim me ASHSH-në dhe Muzeun e Historisë së Natyrës, në Vjenë, dhe ekspozita dyditore (13 maj-31 korrik 2025) kushtuar “Kalorësit të Babunjës”, si një nga zbulimet arkeologjike më të rëndësishme të viteve të fundit në Europë; konferenca shkencore “Karl von Gega dhe Semmeringu – Një hekurudhë për të ndryshuar historinë”, në bashkëpunim me Musei Civici di Venezia dhe Universitetin për Biznes dhe Teknologji. Ky aktivitet përfshiu si pjesë të tij albumin me 213 faqe mbi Karl Gegën dhe ekspozitën (12-25 qershor 2025).

Më tej, ai ndali në kontributin e studiuesve të ASHSH-së në Kongresin e 13-të të Studimeve të Europës Juglindore, që u zhvillua në datat 15-19 shtator 2025 në Akademinë e Shkencave të Maqedonisë në Shkup dhe në konferencën shkencore ndërkombëtare “Studimet albanistike të sllavët e jugut”, organizim i ASHSH-së dhe i ASHAK-ut (27-28 tetor 2025).



Akad. Hoxha vlerësoi, gjithashtu, konferencën “Shqipëria në periudhën bizantine”, ku përmes 5 seksioneve dhe 40 kumtesave akademikët e studiuesit hodhën dritë në një nga periudhat më pak të studiuara, duke sjellë qasje të reja ndaj procesit të integrimit, transformimit dhe vazhdimësisë së kulturës bizantine në territorin shqiptar; konferencën shkencore mbarëkombëtare “Gjurmët e fjalës”, kushtuar 100-vjetorit të lindjes së shkrimtarit Martin Camaj , njërit prej krijuesve më kompleks e më përfaqësues të identitetit shqiptar, dhe konferencën e dytë ndërkombëtare: “Ndryshimet demografike dhe dinamika e tregut të punës - Sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik në Shqipëri, Kosovë dhe rajon” që u organizua nga ASHSH-ja në bashkëpunim me ASHAK-un.

Kryetari i Seksionit u ndal edhe në projektet më të rëndësishme të ASHSH-së, ku spikati punën që po bëhet për realizmin me sukses të tri veprave madhore të ndërmarra nga Akademia e Shkencave: “Fjalori i madh i gjuhës shqipe”, “Historia e shqiptarëve”, “Enciklopedia shqiptare”. Është hedhur tashmë online “Fjalori i gjuhës shqipe”, i cili është pritur me interes jashtëzakonisht të madh. Janë në procesin përfundimtar të recensimit dhe përgatitjes për botim dy volumet e para të veprës “Historia e shqiptarëve”. Në bashkëpunim me kolegët nga Kosova ka përfunduar me sukses nga redaksitë e fushave të “Enciklopedisë shqiptare” fjalësi me përcaktimin e madhësive përkatëse dhe emrat e autorëve që do t’i shkruajnë.

Më tej, ai vuri në dukje disa nga botimet madhore, si: Tre vëllimet e veprës “Kadareja në kritikën botërore”, me autor Bashkim Kuçukun. Vepra u promovua në ASHSH me rastin e 90-vjetorit të lindjes së shkrimtarit; “Studime albanologjike në indoeuropianistikë, filologji dhe gjuhësi kontakti”, vëllim në nderim të prof. Bardhyl Demirajt; “Vepra letrare e Francesco Anton Santorit”, vëllimi III, me autor akad. Matteo Mandalà; “Krestomaci e albanologjisë” (vëllimi I), i hartuar nga prof. dr. Tefë Topalli dhe vëllimi i dytë me autor Artan Haxhin; Monografia “Liqenet akullnajore të Shqipërisë”, e hartuar nga prof. dr. Perikli Qiriaz, dr. Adriatik Balla dhe dr. Florian Fusha etj.

Pasi bëri një paraqitje të ecurisë dhe vlerësimit të punës së instituteve, qendrave, njësive, në tërësi, akad. Hoxha u ndal në vlerësimin mbi veprimtaritë individuale të akademikëve të ASHSH-së. Nga skedat e punës individuale të 16 akademikëve për vitin 2025 ka një produktivitet të dukshëm, i argumentuar me pjesëmarrjen në 19 projekte kombëtare, 12 projekte ndërkombëtare, 34 botime monografike, 27 pjesëmarrje në konferenca kombëtare dhe 44 konferenca ndërkombëtare, si dhe 18 recesione librash e artikujsh të rëndësishme shkencorë. Gjithashtu 8 akademikë janë aktivë në mësimdhënie në arsimin e lartë.

Në vijim, u diskutua ecuria e punës me revistat shkencore dhe u dhanë ide për përmirësimin, rritjen e faktorit të impaktit, forcimin e prurjeve shkencore dhe paraqitjen bashkëkohore, si dhe të merren masat për indeksimin dhe vijimin e punës për revistën “Studia Albanica” 2026-1. Për indeksimin online të revistave të ASHSH-së po punohet nga sekretarja shkencore akad. Anila Hoda, prof. asoc. Gjon Boriçi e dr. Jonida Gashi.

Në fund, pasi u analizuan nga sekretarja shkencore akad. Anila Hoda disa nga problematikat e vitit të kaluar për revistat shkencore, u theksua se një nga perspektivat më të rëndësishme të këtij viti është dalja në kohë e revistave dhe garantimi i cilësisë dhe etikës në botimin e artikujve shkencorë.

Lidhur me realizmin e projekteve të vitit 2026, akad. Hoxha e vuri theksin në bashkëpunimin me ASHAK-un dhe institucionet e tjera me projekte të mirëorganizuara dhe afatgjata. Mbetet me rëndësi vëmendja për zbatimin dhe përmirësimin në vazhdimësi të strategjive shumëvjeçare, veçanërisht të instituteve të albanologjisë për të realizuar kërkimin shkencor në nivel bashkëkohor.

Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike zhvilloi takimin për analizën e veprimtarive të kryera për vitin 2025 dhe planifikimet e aktiviteteve për vitin 2026



Në datën 5 shkurt 2026, Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, realizoi takimin për analizën e punës të vitit 2025 dhe draf-programin e veprimtarive për vitin 2026.

Takimi u drejtua nga Kryetari i Seksionit akad. Neki Frashëri, ku ishin të pranishëm sekretarja shkencore e ASHSH-së, akad. Anila Hoda, dhe drejtuesit e instituteve, komisioneve dhe qendrave kërkimore të ASHSH-së.

Akad. Neki Frashëri, pasi i njohu pjesëmarrësit me përmbajtjen e mbledhjes dhe arritjet e vitit 2025, theksoi se raporti bazohet në kontributet e përbashkëta, duke reflektuar punën e komisioneve, njësive dhe drejtuesve të veprimtarive nëpërmjet një analize gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar. Më tej, ai bëri sqarime mbi draft-raportin vjetor që po përgatitet.

Pas diskutimeve, akad. Frashëri dha udhëzime lidhur me buxhetin, administrimin e projekteve dhe koordinim e mirë me institucionet dhe palët bashkëpunuese.

Pasi seksioni diskutoi dhe miratoi në parim raportin e vitit 2025 dhe propozimet e veprimtarive për vitin 2026, u ngrit një komision për zgjedhjen e dy anëtarëve të jashtëm të ASHSH-së.

U propozua nga komisioni dhe u aprovua me shumicë votash zgjedhja si anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë e prof. dr. Burim N. Ametaj dhe e prof. Hubert Hasenauer.



Pranime të reja në Akademinë e Shkencave

Prof. dr. Hubert Hasenauer u zgjodh anëtar nderi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë



Asambleja e Akademisë së Shkencave në mbledhjen e saj vjetore zgjodhi prof. dr. Hubert Hasenauer anëtar nderi.

Kandidatura e prof. dr. Hubert Hasenauer, e propozuar nga Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike, pranë ASHSH-së, u paraqit nga kryetari akad. Skënder Gjinushi, i cili vlerësoi kontributin e tij në fushat e ekologjisë pyjore, modelimit të ekosistemeve, menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore e më gjerë.

Prof.dr. Hubert Hasenauer është një nga personalitetet më të spikatura të shkencave të natyrës dhe të qeverisjes universitare në nivel europian dhe ndërkombëtar, profesor i menaxhimit të ekosistemeve pyjore dhe ish-Rektor i Universitetit të Burimeve Natyrore dhe Shkencave të Jetës (BOKU), Vjenë, Austri, shkencëtar me një profil të jashtëzakonshëm akademik dhe institucional.

Ai ka dhënë kontribut të gjerë në fushat e ekologjisë pyjore, modelimit të ekosistemeve, menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe rolit të pyjeve në ciklin global të karbonit, autor i qindra publikimeve shkencore me ndikim të gjerë në politikat shkencore dhe mjedisore ndërkombëtare, me një leadership të shquar në qeverisjen universitare.

Prof. dr. Hasenauer, si kryetar i Senatit Akademik dhe më pas si Rektor i Universitetit BOKU, ka udhëhequr procese të rëndësishme modernizimi institucional,

ndërkombëtarizimi dhe sigurimi të cilësisë në arsimin e lartë, me një angazhim të veçantë dhe afatgjatë në mbështetje të reformimit të arsimit të lartë shqiptar, si koordinator i projektit strategjik UTB-BOKU 2030.

Ai ka kontribuar drejtpërdrejt në afrimin e universiteteve shqiptare me standardet më të avancuara evropiane të qeverisjes universitare, kërkimit shkencor dhe zhvillimit të kurrikulave.

Prof. dr. Hasenauer ka një rol të rëndësishëm në forcimin e bashkëpunimit akademik ndërkombëtar dhe integrimin e studiuesve shqiptarë në rrjetet akademike evropiane dhe globale, duke rritur ndjeshëm shkëmbimin shkencor dhe ndërveprimin institucional ndërkombëtar.

Prof. dr. Burim N. Ametaj u zgjodh anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë



Asambleja e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në mbledhjen e saj vjetore zgjodhi prof. dr. Burim N. Ametaj anëtar të jashtëm të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Kandidatura e prof. dr. Burim N. Ametaj e propozuar nga Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike, pranë ASHSH-së, u paraqit nga kryetari akad. Skënder Gjinushi, i cili vlerësoi kontributin e tij në nivel ndërkombëtar në fushën e mjekësisë veterinare dhe biologjisë sistemike.

Prof. dr. Burim N. Ametaj është profesor në Universitetin e Albertës, Kanada, dhe një nga studiuesit më të shquar në nivel ndërkombëtar në fushën e mjekësisë veterinare dhe biologjisë sistemike. Prof. dr. Ametaj renditet në krye të 0.5% të studiuesve globalë sipas ScholarGPS dhe është ndër studiuesit më të cituar në kërkimin mbi gjedhin qumështor dhe shkencën e qumështit.

Ai ka publikuar mbi 120 artikuj shkencorë të rishikuar nga kolegët, me më shumë se 8,400 citime dhe një h-indeks 49, tregues të një ndikimi të qëndrueshëm dhe të thellë në fushën e tij. Puna e tij ka luajtur një rol kyç në zhvillimin e metabolomikës si mjet

qendror për diagnostikën, parashikimin dhe menaxhimin e sëmundjeve në blegtorinë e qumështit me precizion.

Një aspekt thelbësor i kontributit shkencor të prof. dr. Ametaj është rikonceptualizimi i mjekësisë veterinarë nga një qasje reduksioniste drejt një kuptimi sistemik të shëndetit dhe sëmundjes. Përmes punimeve të tij teorike dhe empirike, ai ka demonstruar se sëmundjet periparturiente nuk janë entitete të izoluara, por pasojë e ndërveprimeve komplekse midis metabolizmit, sistemit imunitar dhe mikrobiomës. Këto koncepte kanë sjellë zhvendosje paradigmатike në menaxhimin e shëndetit të gjedhit qumështor dhe kanë hapur perspektiva të reja kërkimore edhe për shëndetin e njeriut.

Ai ka kontribuar gjithashtu në zhvillimin e mjekësisë parashikuese dhe parandaluese, duke identifikuar biomarkerë metabolikë që mundësojnë zbulimin e hershëm të sëmundjeve javë përpara shfaqjes klinike. Përtej kërkimit themelor, ai është aktiv në transferimin e njohurive drejt aplikimeve praktike, përmes zhvillimit të bioteknologjive inovative dhe produkteve të komercializuara. Ai është kryeredaktor themelues i revistës ndërkombëtare Dairy (MDPI) dhe ruan lidhje të forta bashkëpunimi me institucionet shkencore shqiptare, duke kontribuar në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe parimeve të qasjes One Health.

Prof. dr. Ametaj falënderoi Kryetarin e ASHSH-së akad. Gjinushin dhe anëtarët e Asamblesë për vlerësimin e lartë

Prof. dr. Orion Çiftja u zgjodh anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë



Asambleja e Akademisë së Shkencave në mbledhjen e saj vjetore zgjodhi prof. dr. Orion Çiftjan anëtar të jashtëm të Akademisë. Kandidatura e prof. Çiftjas, e propozuar nga Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike u paraqit nga kryetari i ASHSH-së, akad. Skënder Gjinushi, i cili vlerësoi kontributin e tij në studime me tema të gjera nga fizika teorike e materies së kondensuar dhe fizika kompjuterike.

Prof. dr. Orion Çiftja është diplomuar në Universitetin e Tiranës në vitin 1991 dhe ka marrë doktoraturën në Fizikë në vitin 1997 nga International School of Advanced Studies (SISSA/ISAS), Trieste, Itali, në fushën e Fizikës Teorike të Materies së Kondensuar.

Në vitin 2002, prof. dr. Orion Çiftja u bashkua me Prairie View A&M University pas një përvoje pesëvjeçare postdoktorale në disa universitete amerikane. Prej disa vitesh ai mban postin e profesorit në këtë universitet.

Kërkimet e prof. dr. Orion Çiftjas përfshijnë një gamë të gjerë temash nga fizika teorike e materies së kondensuar dhe fizika kompjuterike.

Ai ka botuar vetëm ose me bashkautorë shumë artikuj në revistat më të rëndësishme ndërkombëtare dhe kërkimi i tij njihet për kombinimin e rigorozitetit analitik me qasjet kompjuterike të avancuara për zgjidhjen e problemeve thelbësore në teorinë moderne të materies së kondensuar.

Prof. dr. Orion Çiftja është anëtar Fellow i American Physical Society, një njohje që vlerëson kontributet e tij domethënëse dhe afatgjata në fushën e fizikës. Ai ka marrë disa çmime kërkimore nga National Science Foundation (NSF) dhe organizata të tjera federale financuese.

Prof. dr. Çiftja bën pjesë në bordet redaktuese të disa revistave shkencore. Është e rëndësishme të theksohet se ai, që me themelimin e Institutit Kombëtar të Fizikës është anëtar i bordit dhe kontribuon me përkushtim në avancimin e kërkimeve shqiptare në fizikë.

Pas zgjedhjes së prof. dr. Çiftjas me shumicë dërmuese prej Asamblesë, Kryetari i ASHSH-së i uroi mirëseardhjen e shprehu bindjen se kjo zgjedhje do të shërbejë për rritjen e kontributit të profesorit në kuadër të Institutit e si shembull për brezat se edhe shqiptarët mund të arrijnë në nivelet më të larta të kërkimit shkencor.

Prof. dr. Orion Çiftja falënderoi Kryetarin e ASHSH-së akad. Gjinushin dhe anëtarët e Asamblesë për vlerësimin e lartë, duke u shprehur se ndihet mjaft i nderuar dhe ky vlerësim e obligon që të ketë një bashkëpunim më të ngushtë me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe qendrat kërkimore të vendit.

Akad.asoc. Kozeta Sevrani fitoi titullin akademik



Asambleja vlerësoi punën dhe rezultatet në kërkimin shkencor të akademikes së asociuar Kozeta Sevrani, që pas votimit mori titullin akademik.

Formimi i saj akademik mbështetet në një bazë të fortë në shkencat ekzakte dhe aplikative. Ajo është diplomuar në vitin 1984 në Fakultetin e Shkencave të Natyrës për fizikë (program 5-vjeçar) dhe që në fillimet e karrierës akademike është profilizuar në fushën e informatikës dhe aplikimeve të teknologjisë së informacionit.

Studimet doktorale, të përfunduara në vitin 1997, i ka bërë në informatikë të aplikuar, duke vijuar një proces kualifikimi dhe specializimi profesional brenda dhe jashtë vendit, që ka kontribuar në ndërtimin e një profili ndërdisiplinor që ndërthur informatikën, statistikat dhe ekonominë.

Që prej vitit 2021, ajo ka botuar 11 artikuj shkencorë në revista të indeksuara, nga të cilët 8 në Scopus, përfshirë disa botime në revista të kategorisë Q1, si dhe ka realizuar mbi 40 prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Fushat kryesore të kërkimit të saj përfshijnë transformimin digjital, shkencën e të dhënave, inteligjencën artificiale, sistemet e informacionit dhe aplikimet e teknologjive inteligjente në ekonomi, turizëm dhe shëndetësi.

Së fundmi, ajo është bashkautore e monografisë “Teknologjitë inteligjente në Industrinë e mikpritjes në Shqipëri: Një kornizë zbatimi për një turizëm të qëndrueshëm”.

Në këtë periudhë, Kozeta Sevrani ka qenë e përfshirë në pesë projekte të rëndësishme kërkimore, të financuara nga AKKSHI dhe programet Erasmus+, me fokus në digjitalizimin e arsimit të lartë, integrimin e teknologjive smart, data journalism dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Paralelisht, ajo udhëheq aktualisht tre doktoratura dhe kontribuon aktivisht në formimin e studiuesve të rinj.

Angazhimi i saj institucional përfshin: rolin si Kryetare e Këshillit të Statistikave të Shqipërisë; anëtare e Bordit të Rrjetit Akademik Shqiptar; eksperte e Strategjisë së Specializimit të Zgjuar, si dhe pjesëmarrjen në komisione dhe njësi shkencore pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, përfshirë Njësinë e Inteligjencës Artificiale.

Ajo është gjithashtu aktive në veprimtari editoriale dhe shkencore ndërkombëtare, si anëtare ose drejtuese e bordeve editoriale dhe komiteteve shkencore të revistave dhe konferencave akademike.



I jepet diploma e mirënjohjes “Nderi i Akademisë” prof. dr. Priamo Bollanos në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Athinë



Sot në datën 11 shkurt 2026, në një ceremoni të veçantë të zhvilluar në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Republikën e Greqisë, u dha mirënjohja “Nderi i Akademisë” (ASHSH) për prof. dr. Priamo Bollanon.

Ceremoninë e çeli ambasadorja znj. Luella Hajdaraga, e cila i uroi mirëseardhjen delegacionit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, prof. dr. Bollanos dhe familjes së tij, si dhe miqve të shumtë të profesorit.

Pasi foli për vlerat e prof. dr. Bollanos, ambasadorja Hajdaraga falënderoi për bashkëpunimin Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe ftoi akademik Skënder Gjinushin, kryetar i ASHSH-së për të dhënë titullin e lartë të mirënjohjes akademike.

Akademik Gjinushi evidentoi vlerat dhe rëndësinë e këtij titulli që iu jepet personaliteteve të shquara shkencore nga fusha të ndryshme, për kontributet e tyre në vijimësi dhe lexoi motivacionin e dedikuar për prof. dr Bollanon:

Prof. dr. Priamo Bollanos “i jepet titulli 'Nderi i Akademisë' për rolin thelbësor në modernizimin e arsimit në fushën e shkencave ekonomike, forcimin e metodologjisë shkencore dhe etikës profesionale në institucionet e arsimit të lartë, administratën

publike, institucionet kërkimore-shkencore, duke ndikuar drejtpërdrejt në formimin e brezave të ekonomistëve dhe studiuesve. Punimet e tij përbëjnë sot një fond të çmuar reference për historinë dhe evolucionin e mendimit ekonomik në Shqipëri, për promovimin e ekonomisë si shkencë shoqërore, të lidhur ngushtë me drejtësinë, përgjegjësinë publike dhe integritetin profesional. Figura e tij përfaqëson modelin e intelektualit që e sheh dijen si mision shërbimi ndaj shoqërisë e shërben si një mesazh frymëzues për brezat e rinj. Përkushtimi afatgjatë i prof. dr. Bollanos ndaj dijes dhe etikës, mbetet standardi më i lartë i suksesit akademik e institucional”.




Në fjalën përshëndetëse profesor Bollano pasi falënderoi Akademinë e Shkencave të Shqipërisë për vlerësimin e lartë, Ambasadën e Republikës së Shqipërisë si organizuese e veprimtarisë bëri një përshkrim mbresëlënës të jetës së tij akademike dhe shoqërore, për sfidat me të cilat është përballur dhe arritjet e veprimtarisë kërkimore shkencore, administrative e shtetërore.

Aktivitetin e përshëndeti gjithashtu edhe akademik Anastas Angjeli, koleg dhe bashkëpunëtor i profesor Bollanos.

Në fund të pranishmit i shprehën urimet profesor Bollanos me rastin e 90 - vjetorit të lindjes.

Të tjera

“Shën Sofia: Kishat e Mençurisë së Tënjëzoti nëpër botë”, promovohet vepra shqip që u bashkohet 15 gjuhëve të botës



Në ambientet e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë u zhvillua prezantimi i vëllimit “Shën Sofia: Kishat e Mençurisë së Tënjëzoti nëpër botë”.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, së bashku me Kuvendin e Shqipërisë dhe Asamblenë Ndërparlamentare për Ortodoksinë, mirëpriti këtë aktivitet promovues jo vetëm si institucion që i kushtohet shkencës dhe dijes, por edhe si mikpritëse e vlerave të trashëgimisë kulturore universale, të cilat na bashkojnë përtej kufijve gjuhësorë, fetarë dhe kulturorë.

Veprimtaria pati si qëllim pasqyrimin e trashëgimisë historike, kulturore dhe shpirtërore të Kishave të ndryshme në botë që mbajnë këtë emër.

Në fjalën e tij përshëndetëse Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi falënderoi të pranishmit për bashkëpunimin ndërinstitutional, ku theksoi se botimi në shqip u bashkohet botimeve në 15 gjuhë të botës si një dëshmi e përpjekjeve të përbashkëta për të shpërndarë njohuri, reflektime dhe respekt për monumentet historike që simbolizojnë besimin, dashurinë dhe shpresën.

Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë z. Niko Peleshi, Fortlumturia e tij Kryepeshkopi Joan i Tiranës, i Durrësit e i gjithë Shqipërisë dhe pjesëmarrësit e tjerë në këtë veprimtari

në fjalën e tyre theksuan rëndësinë dhe vlerën e librit “Shën Sofia: Kishat e Mençurisë së Tënëzoti nëpër botë” dhe të dialogut ndërkulturor e ndërfetar.

Krahas prezantimit të botimit, në përmbyllje të aktivitetit në mjediset e Akademisë së Shkencave u hap edhe një ekspozitë fotografike e kishave të Shën Sofisë nga e gjithë bota.

Për më tepër, lexo linkun:

<https://akad.gov.al/shen-sofia-kishat-e-mencurise-se.../>



U mbajt veprimtaria jubilarë “Profesor Neritan Ceka në 85-vjetorin e lindjes. Gjashtë dekada për arkeologjinë”



Veprimtaria jubilarë në nderim të punës dhe kontributit të arkeologut prof. dr. Neritan Ceka, me rastin e 85-vjetorit të lindjes, u mbajt më 12 shkurt 2026.

Aktiviteti u organizua nga Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, Komisioni i përhershëm i arkeologjisë dhe Instituti i Arkeologjisë, pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Akad. Adem Bunguri drejtori i Institutit të Arkeologjisë në fjalën e hapjes shprehu falënderimet për kryetarin e Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushin dhe për të gjithë akademikët e organizatorët e kësaj e veprimtarie jubilarë që mbahet në nderim të arkeologut të përkushtuar prof. dr. Neritan Ceka.

Veprimtaria nisi me tinguj muzikorë të interpretuar nga pianistja e njohur Rudina Ciko.

Fjalën përshëndetëse në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave e mbajti akad. Gëzim Hoxha, kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike. Ai e vlerësoi prof. dr. Cekën si një prej figurave më përfaqësuese të arkeologjisë shqiptare dhe të jetës akademike e publike në vendin tonë. Prof. dr. Ceka i përket atij brezi studiuesish që e ndërthuri shkencën arkeologjike shqiptare mbi bazën e kërkimit sistematik të punës në terren dhe të dialogut me shkencën ndërkombëtare. Formimi i tij universitar i ndjekur nga një veprimtari e gjatë kërkimore dhe pedagogjike u përkthye në një kontribut të qëndrueshëm për njohjen e qytetërimit ilir dhe të trashëgimisë antike. Më tej, akad. Hoxha foli për rezultatet e gërmimeve të prof. dr. Cekës dhe të monografive e botimeve shkencore të hartuara shpesh me studiues të huaj, duke i vlerësuar si

dëshmi të një qasjeje moderne në disiplinat e shkencës së arkeologjisë. Ai tha se prof. Neritan Ceka mbetet një pikë referimi e rëndësishme për arkeologjinë shqiptare.

Akad. Adem Bunguri, drejtor i Institutit të Arkeologjisë (ASHSH) mbajti kumtesën me temën “Neritan Ceka dhe gjeneratat arkeologjike në vitet ‘70”. Ai foli për pjesëmarrjen aktive në ekspedita arkeologjike dhe përkushtimin e prof. dr. Cekës, i cili u njoh me këtë disiplinë, që kur ishte fëmijë, duke ndjekur në ekspedita babanë e tij, arkeologun e shquar Hasan Ceka. Në formimin arkeologjik të N. Cekës, padyshim ndikoi fuqishëm ambienti i tij familjar dhe përvetësimi i shpejtë i gjuhëve të huaja, pikësëpari i gjermanishtes.



Neritan Ceka është përfaqësues i spikatur i brezit të dytë të arkeologëve shqiptarë, krahas arkeologëve të tjerë të kësaj gjenerate si M. Korkuti, B. Jubani, Zh. Andrea, A. Baçe, A. Meksi, S. Aliu, dhe më vonë D. Komata, F. Drini, N. Bodinaku, A. Koka etj.

Gjatë 6 dekadave të kontributit të tij në arkeologji prof. dr. Ceka ka hedhur dritë në shtrirjen e kulturës qytetare ilire në pjesën më të madhe të territorit që banohej në antikitete nga popullsia ilire, duke e lidhur ngushtë me shpjegimin e fillimit të tyre, si dhe me problemin e gjenezës së jetës qytetare tek ilirët.

Veprimtaria e tij studimore është përqendruar në kërkimet mbi qytetet antike ilire, lindjen dhe gjenezën e qytetërimit ilir dhe historinë e shtetit tek ilirët. Ai ka kryer një numër të konsiderueshëm gërmimesh në mjaft qendra antike të Shqipërisë. Përmes gërmimeve në Belsh, Margëlliç dhe Mashkjezë, ai dëshmoi praninë e një periudhe protourbane në shek. VII-V para Kr., që paraprin formimin dhe lulëzimin e qyteteve ilire në shek. IV-III para Kr.

Prof. dr. Neritan Ceka vlerësohet si zbulues i monumenteve të Bylisit, së bashku me prof. dr. Skënder Muçaj. Gjatë një periudhe 60-vjeçare ai ka dhënë kontribut në fushën e arkeologjisë

prehistorike e të arkeologjisë ilire, duke e zgjeruar fushën e studimeve mbi qytetin ilir.

Akad. Bunguri përmendi mes dhjetëra kontributeve edhe botimin e 15 monografive shkencore, artikujve të shumë shkencorë në revista kombëtare e ndërkombëtare, si dhe kontributet e tjera në mësimdhënie, udhëheqje të temave të disertacioneve, duke asistuar edhe si bashkëpunues në gërmime arkeologjike me shkollat e universitetet. Ai e vlerësoi prof. dr. Cekën edhe si zërin më të fuqishëm në studiot televizive për çështje e probleme të mprehta të arkeologjisë shqiptare.



Dy kolegët, akad. Apollon Baçe e prof. dr. Skënder Muçaj nëpërmjet kujtimeve shprehën respektin e thellë për personalitetin prof. dr. Cekës si mik, shok e bashkëpunëtor dhe më tej edhe për kontributin, bashkëpunimet në fushën e arkeologjisë. Ata vlerësuan mbi të gjitha përkushtimin e prof. Cekës në kërkimin dhe studimin e objekteve arkeologjike dhe të gjurmëve të historisë së antikitetit, me një tërheqje të fortë drejt qytetit të madh të Bylisit, duke zbuluar teatrin, stadiumin, shëtitoret, gjimnazin dhe disa nga hyrjet dhe kullat e fortifikimeve të qytetit ilir, duke vlerësuar më tej edhe ekspeditat dhe gërmimet në Butrint, të cilave u është kthyer edhe sot. Ata e vlerësuan prof. dr. Cekën si degë të një dinastie të arkeologjisë shqiptare, që nis me babanë e tij Hasan Cekën, një nga themeluesit e arkeologjisë shqiptare, duke vijuar me të bijën dr. Orgita Cekën.

Në 85- vjetorin e lindjes për arkeologun prof. dr. Neritan Ceka shprehën mirënjohje të thellë dhe vlerësime personalitete të politikës, drejtues të institucioneve të vendit, shoqatave kulturore e më gjerë.

Në mbyllje të veprimtarisë prof. dr. Neritan Ceka falënderoi të gjithë organizatorët, kolegët, miqtë, bashkëpunëtorët në gërmimet arkeologjike e familjarët që kanë qenë pjesë e

udhëtimit në karrierën e tij. Ai shprehu bindjen se puna dhe vepra që ka bërë do të shërbejnë jo vetëm si dëshmi shkencore, por edhe për rindërtimin e qytetërimit tonë.



Akademia e Shkencave uron në datën e tij të lindjes, akademik emeritus Jani Thomain



Kryesia e Akademisë së Shkencave i uron albanologut e mjeshtrit të fjalorëve të gjuhës shqipe, akademik emeritus Jani Thomait, jetë të gjatë, të lumtur e plot shëndet.

Akad. emeritus Jani Thomai ka lindur më 2 shkurt 1935 në Seman të Fierit. Aty kreu dhe mësimet e para.

Nga viti 1958-2008 është punësuar në Institutin e Historisë dhe të Gjuhësisë, Sektori i leksikologjisë dhe i leksikografisë, më pas: Departamenti i leksikologjisë dhe i terminologjisë.

Punoi si përgjegjës i Departamentit të leksikologjisë dhe të terminologjisë në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë dhe në vitet 2003-2008 u emërua kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike në Akademinë e Shkencave. Më pas u zgjodh sekretar shkencor i Akademisë së Shkencave (2008-2009), si dhe bashkëkryetar i Këshillit Ndërkademi për Gjuhën Shqipe, që nga viti 2010.

Gjatë karrierës së tij mbi 65-vjeçare ka fituar disa tituj e grada shkencore. Në vitet 1963-1964 mbrojti tezën “Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe” për gradën “Kandidat i shkencave filologjike”. Në vitin 1967 mbrojti tezën “Prejardhja semantike në gjuhën shqipe” për gradën “Doktor i shkencave filologjike”. Mbrojti titullin shkencor “Profesor” në vitin 1994.

U pranua anëtar i Akademisë së Shkencave në vitin 2003.

Akad. emeritus Jani Thomai është drejtues shkencor projektesh e redaktor shkencor për fjalorët shpjegues (1980, 1984, 2002, 2006, 2012; për fjalorët elektronikë, 2014 - për shkollarët; fjalorët frazeologjikë shqip e ballkanikë (1999); si dhe autor i librave “Për pastërtinë e gjuhës shqipe (Fjalor); “Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe” (2004); “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin

e fjalëve në gjuhën shqipe” (I, II, 1972; III, 1989); “Shqiptarët e Maqedonisë” (1994); “Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë” (2005); “Fjalor me shprehje të huazuara në gjuhën shqipe” (hartuar nga A.Jashari, 2007); “Fjalor frazeologjik shqip-frëngjisht e frëngjisht-shqip” (hartuar nga Daniel Xhoxhaj, 2010); “Historia e popullit shqiptar” (hartuar nga Akademia e Shkencave, vëllimet I, II, III, 2002-2003) etj.

Akad. emeritus Thomai është

anëtar i redaksive të revistave shkencore, bordeve dhe këshillave shkencorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Ai është anëtar në Komitetin Kombëtar të AIESEE (“Shoqata Ndërkombëtare e Studimeve të Europës Juglindore”).

Aka. emeritus Jani Thomai është drejtues i 20 ekspeditave leksikologjike në Shqipëri e në Kosovë për vjelje fjalësh, shprehjesh e kuptimesh.

Ai ka publikuar monografi, vepra shkencore e përmbledhje studimesh si: "Fjalor i gjuhës së sotme shqipe", bashkëhartues e bashkëredaktor, Tiranë, 1980;

"Fjalor i shqipes së sotme", bashkëripunues e redaktor i përgjithshëm, Tiranë, 2002; "Për pastërtinë e gjuhës shqipe" (Fjalor), bashkëhartues e bashkëredaktor, Tiranë, 1998; "Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe"; "Fjalor frazeologjik ballkanik (në pesë gjuhë: shqip - bullgarisht - greqisht - rumanisht - serbokroatisht)", drejtues shkencor i projektit, bashkëhartues dhe redaktor shkencor, Tiranë, 1999; "Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe", drejtues shkencor i projektit, bashkëhartues dhe redaktor shkencor, Tiranë, 2004; "Fjalor i gjuhës shqipe", drejtues shkencor i projektit, bashkëhartues dhe redaktor shkencor, Tiranë, 2008; "Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe", autor, Tiranë, 2010, etj.

Ka botuar librat: "Leksikologjia shqipe", autor, Prishtinë, 1970; "Leksikologjia e gjuhës shqipe", autor, Tiranë, 1974, "Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe", autor, Tiranë, 1981; "Leksikologjia e gjuhës shqipe",

Tiranë, 1981; "Leksikologjia shqipe për shkollat e larta", autor, Prishtinë, 1978; "Libri i gjuhës shqipe 3 (për shkollat e mesme)", bashkautor e redaktor përgjegjës, Tiranë, 1983; "Prejardhja semantike në gjuhën shqipe" autor, Tiranë, 1989; "Teksti dhe gjuha (përmbledhje studimesh); "Semasiologjia leksikore", autor, Tiranë, 1997; "Leksikologjia e gjuhës shqipe" (një seri veprash);

"Fjalor i termave të gjuhësisë", 1975, etj.

Për dhjetëra vjet ka dhënë kontribut të pazëvendësueshëm në leksikografinë shqiptare dhe tani një kontribut thelbësor në hartimin e "Fjalorit të madh të gjuhës shqipe".

Akad. emeritus Jani Thomai është dekoruar me “Çmimi i Republikës” i shkallës së dytë (1984); Urdhri “Naim Frashëri” i klasit të parë (1985); “Qytetar nderi i Myzeqesë” (2001); “Qytetar nderi i rrethit të Fierit” (2008); 'Honoris Causa' i Universitetit "Fan Noli", Korçë.

Për më tepër, lexo linkun:

<https://share.google/9XOQBWR7Dc85OBjtP>

Akademia e Shkencave uron në ditën e tij të lindjes akad. Arjan Durrësin



Akademik Arjan Durrësi, njëri prej shkencëtarëve të shquar të shkencave kompjuterike dhe inteligjencës artificiale, anëtar i Akademisë së Shkencave dhe anëtar i Komisionit të matematikës dhe informatikës ka sot ditëlindjen.

Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe kolegët i urojnë:

Gëzuar ditëlindjen, akademik Arjan Durrësi! Jetë të gjatë e të lumtur dhe arritje të reja në krijimtarinë shkencore.

Akad. Arjan Durrësi lindi më 27 shkurt të vitit 1962. Shkollën e mesme e kreu në Tiranë, ku u vlerësua me medalje te artë.

Më pas kreu Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike (dega elektronikë) të Universitetit të Tiranës (1981–1986), po me Medalje të Artë, ndërsa masterin e kreu në Italian Telecommunication Institute, La Sapienza University, Itali (1991). Ka marrë titullin “Doktor i shkencave” nga Universiteti Politektik i Tiranës në vitin 1993 dhe doktor në shkencat kompjuterike nga Tokyo Denki University, Tokyo, Japoni (2006). Që nga viti

2007 është anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Akad. Durrësi ka punuar si pedagog në katedrën e elektronikës të Universitetit Politeknik të Tiranës (1986–1991). Më vonë ka qenë zv.dekan i Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike të Universitetit Politeknik të Tiranës (1995–1996). Ai ka punuar si kërkues shkencor në departamentin e shkencave të kompjuterëve dhe informacionit në Ohio State University, SHBA (1997–2003), si asistent profesor në departamentin e shkencave të kompjuterëve në Louisiana State University, SHBA (2003–2007). Prej 2007-s e në vazhdim akad. Durrësi është profesor i shkencave të kompjuterëve pranë departamentit të shkencave kompjuterike në Indiana University Purdue University, Indianapolis SHBA.

Karriera e tij jashtë Shqipërisë ka nisur në pozicione të larta në LSU dhe Universitetin Shtetëror të Ohajos. Më parë akad. Arjan Durrësi ka pasur pozicione akademike e shkencore pranë Louisiana State University, Ohio State University dhe Universitetit Politeknik të Tiranës. Gjithashtu, ai ka mbi tridhjetë kontribute në organizatat e standardizimit si IETF, Forumi i ATM, ITU, ANSI dhe TIA. Ai është PI i katër projekteve kërkimore të financuara nga NSF. Kërkimi i tij është financuar nga Shtetet e Ohajos dhe Luiziana, si dhe burime të universitetit dhe industrisë. Aktiviteti i tij shkencor është mbështetur nga National Science Foundation, universitete dhe kompani në SHBA.

Arjan Durrësi ka organizuar dhjetëra konferenca dhe ngjarje ndërkombëtare shkencore, si p.sh., bashkëdrejtues i BalkanCom 2017, the First International Balkan Conference on Communications and Networking etj dhe ka qenë në bordet botuese të shumë revistave shkencore, si "Ad Hoc Networks Journal", "Journal" etj.

**Akademia e Shkencave uron në ditën e tij të lindjes albanologun e shquar
arbëresh akad. Francesco Altimarin**



Akademik Francesco Altimari, personalitet i shquar i botës arbëreshe dhe albanologjisë, anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë ka sot ditëlindjen.

Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, miqtë dhe kolegët e tij i urojnë:

Jetë të gjatë, plot shëndet e krijimtari, miku dhe kolegu ynë i dashur, akademik Francesko Altimari!

Francesco Altimari lindi më 21 shkurt 1955 në Shën Mitër në Kalabri, Itali, dhe është me prejardhje arbëreshe. Pasi mbaroi liceun në vendlindje në vitin 1973, u diplomua në Fakultetin e Letërsisë dhe Filozofisë të Universitetit të Kalabrisë në vitin 1978. Më 1980-n nisi karrierën akademike si profesor i Universitetit të Kalabrisë, shef katedre në degën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe të Institutit Universitar Lindor të Napolit (1991). Ka qenë

profesor i rregullt i gjuhës dhe i letërsisë shqipe në Universitetin e Kalabrisë që nga viti 1992. Ai ka dhënë të njëjtën lëndë edhe në Universitetet e Napolit "L'Orientale" (1991-'92), të Leçes (1993-'97), të Triestes (2000-2001) dhe Milanos-Cattolicës (2004-'22).

Akad. Altimari është redaktor shkencor i botimit të "Opera Omnia të Girolamo De Radës" (1814-1903). Ai është autor i disa monografive mbi filologjinë, gjuhësinë dhe letërsinë shqipe dhe arbëreshe, si dhe eseve të shumta mbi studimet shqipe dhe ballkanike në revista të specializuara, si italiane ashtu edhe ndërkombëtare.

Është anëtar nderi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë që nga viti 2006 dhe anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës që nga viti 2008.

Akad. Altimari është President i Fondacionit të Universitetit "Francesco Solano", i themeluar në vitin 2009 nga Universiteti i Kalabrisë për të promovuar gjuhën dhe kulturën shqipe në Itali; për të nxitur shkëmbimet kulturore midis komuniteteve historike shqiptare në Itali dhe atyre në Ballkan (Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Greqia dhe Mali i Zi) dhe për të siguruar mbështetje për aktivitetet e bashkëpunimit shkencor dhe arsimor të UNICAL në Ballkan. Gjithashtu është bashkërendues shkencor i Arkivit Leksikografik Arbëresh (ALA), i projekteve "Besa", "Vatra" dhe drejtues i doktoranturës ndërkombëtare në albanologji (2002).

Akad. Altimari ka botuar dhjetëra vepra shkencore si: "Studime mbi letërsinë shqiptare të Rilindjes" (1984); "Ekzili i fjalës - Minoriteti gjuhësor arbëresh në Itali" (bashkautor) (1986); "Dialektet italo-shqiptare" (bashkautor) (1994); "Bagëti' e Bujqësia" e Naim Frashërit", botim kritik me konkordanca leksikore (1995); "Këngët paramilosaoiane të G. De Radës", botim kritik me konkordanca leksikore (1998, 2005); "Vëzhgime gjuhësore dhe letrare arbëreshe" (2002) etj.

Për kontribute e shquara për krijimin e institucioneve akademike e të qendrave kërkimore-shkencore, si për institucionalizimin dhe përdorimin e arbërishtes shekullore në institucionet publike të vendbanimeve arbëreshe e më gjerë, akad. Altimari është vlerësuar me çmime të larta dhe tituj nderi si: diploma nderi nga Universiteti i Tiranës (2007), Universiteti i Europës Juglindore në Tetovë, Maqedonia e Veriut (2013), Universiteti "Eqrem Çabej" në Gjirokastrë (2016) dhe Universiteti "Aleksandër Moisiu" në Durrës (2017) etj.

Akademia e Shkencave uron në datën e saj të lindjes akademiken Mimoza Hafizi



Akad. Mimoza Hafizi, anëtare e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe drejtuese ekzekutive e Institutit Kombëtar të Fizikës ka sot ditëlindjen. Akademia e Shkencave i uron:

Jetë të gjatë, shëndet e suksese në krijimtari!

Akad. Hafizi është astrofizikane, pedagoge dhe politikane shqiptare.

Lindi më 20 shkurt 1962 në Shkodër. Studimet e para i kreu në vendlindje në gjimnazin “29 Nëntori”. Më pas u diplomua në Fakultetin e Shkencave Natyrore, Universiteti i Tiranës, për fizikë speciale, diplomë e shoqëruar me Medaljen e Artë. Studimet pasuniversitare i ka përfunduar në fushën e studimit për relativitetin e përgjithshëm dhe në teorinë e grupeve.

Akad. Hafizi është pedagoge në Departamentin e Fizikës, Universiteti i Tiranës,

që prej vitit 1995. Studimet doktorale i ka kryer në Francë, D.E.A e Fizikës Teorike në École Normale Supérieure, Paris. Fushat e saj të kërkimit janë shpërthimet Gama - ngjarjet më energjike në Univers, si dhe ekzoplanetet - planetet përtej Sistemit Diellor, përmes metodës së mikrolenteve gravitacionale. Fushat e mësimdhënies janë astrofizika dhe mekanika kuantike.

Akad. Hafizi ka qenë deputete në Kuvendin e Shqipërisë dhe zv.ministre e Arsimit dhe Shkencës. Për katër vjet, ka drejtuar departamentin e fizikës. Ajo është autore e disa librave mbi mekanikën kuantike dhe mbi astrofizikën, të përdorura nga studentët e universiteteve shqiptare. Akad. Hafizi ka krijuar Qendrën Astrofizike në Shqipëri për informimin e publikut dhe është aktive në komunikimet e shkencës, veçanërisht me të rinjtë. Ajo ka shkruar katër romane shkencore: "Pika Trëndafil" (2018), në lidhje me zbulimin e ekzoplanetëve; "Infiniti blu", në lidhje me pafundësinë në shkencë, matematikë, filozofi dhe letërsi; "Duke pritur supernovën", në lidhje me disa nga dukuritë më komplekse të universit dhe fenomeneve të tjera qiellore dhe "Drita".

Ka vazhduar veprimtarinë e saj kërkimore-shkencore brenda vendit dhe në kuadër të programeve ndërkombëtare në fushën e fizikës dhe astrofizikës.

Akad. Hafizi është anëtare e grupit ndërkombëtar "Theseus" dhe të "Cost Action"; anëtare e bordit drejtues të ALLEA-s për periudhën 2024-2027. Është autore dhe bashkautore e disa artikujve shkencorë të botuar jashtë vendit në revista të indeksuara, si dhe pjesëmarrëse në referime e ngjarje shkencore ndërkombëtare dhe brenda vendit.

Akad. Hafizi është vlerësuar me shumë çmime dhe tituj nderi, si: dekorata "Chevalier dans l'Ordre des Palmes Académiques, 2008, "Pour services rendues à la culture française" ("Kalorëse e Urdhërit të Palmës Akademike 2008", "Për shërbimet e ofruara kulturës franceze"); Medalja e Artë e Universitetit "Fan Noli", Korçë, dhe çmimin kombëtar për "Letërsinë për të rinj dhe fëmijë" 2018 për veprën "Pika trëndafil", janar 2020.

Prof. dr. Fjoralba Cakoni shpallet fituese e ligjërimit “Sonia Kovalevsky”



-Ligjërata do të mbahet gjatë takimit vjetor të SIAM, në Cleveland, Ohio, SHBA, më 6–10 korrik 2026-

Shoqata për Gratë në Matematikë (AWM) dhe Shoqëria për Matematikën Industriale dhe të Aplikuar (SIAM) kanë zgjedhur prof. dr. Fjoralba Cakonin lektore të vitit 2026, në kuadër të ciklit prestigjioz të ligjëratave “Sonia Kovalevsky”.

Ligjërimi do të mbahet gjatë takimit vjetor të SIAM 2026, që do të zhvillohet në Cleveland, Ohio, SHBA, në datat 6–10 korrik 2026.

Ky vlerësim përbën një nga nderimet më të rëndësishme ndërkombëtare në fushën e matematikës së aplikuar dhe jepet për personalitete me kontribute të spikatura shkencore.

Prof. dr. Fjoralba Cakoni, anëtare e jashtme në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe Drejtore Ekzekutive e Institutit Kombëtar të Matematikës, njësi virtuale pranë ASHSH-së është profesore e dalluar e Matematikës në Universitetin Rutgers, SHBA. Ajo është anëtare e Shoqatës Amerikane të Matematikës (AMS) dhe e SIAM.

Prof. dr. Cakoni është autore dhe bashkautore e mbi 120 artikujve shkencorë dhe tre monografive.

Krahas veprimtarisë së saj të suksesshme ndërkombëtare, prof. dr. Fjoralba Cakoni ka mbajtur lidhje të vazhdueshme akademike me Shqipërinë, duke kontribuar në promovimin e matematikës dhe në mbështetjen e brezit të ri të studiuesve shqiptarë.

Përmes bashkëpunimit me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe institucioneve të

arsimit të lartë, prof. dr. Cakoni ka kontribuar në forcimin e dialogut shkencor, shkëmbimin e përvojës akademike dhe promovimin e standardeve bashkëkohore të kërkimit në matematikë.

Për më shumë lexoni linkun:

<https://awm-math.org/.../02/PR-Kovalevsky-2026-Cakoni.pdf>



PRESS RELEASE

February 18, 2026

Fioralba Cakoni Named AWM-SIAM Sonia Kovalevsky Lecturer

The Association for Women in Mathematics (AWM) and the Society for Industrial and Applied Mathematics (SIAM) announce that Fioralba Cakoni has been selected as the 2026 Sonia Kovalevsky Lecturer. Her lecture will be delivered at the 2026 SIAM Annual Meeting taking place in Cleveland, Ohio, July 6–10, 2026.

Citation. Professor Fioralba Cakoni is a Distinguished Professor of Mathematics at Rutgers University and is a fellow of both the American Mathematical Society (AMS) and SIAM. She is on the editorial board of the *SIAM Journal of Mathematical Analysis*, the *SIAM Classics in Applied Mathematics* book series, and has recently been appointed as the editor in chief of the journal *Inverse Problems*. Professor Cakoni is one of the founders and leading proponents of the qualitative approach to inverse scattering theory, a development that has been described as a paradigm shift in the field of inverse problems. Her influential research in inverse scattering has shaped the design of new methods in nondestructive testing and wave-based imaging. Central to her work is the study of a new class of non-self-adjoint eigenvalue problems known as transmission eigenvalues, which have attracted substantial attention in both the mathematical community and in applications to inverse problems. This research area is the focus of her book *Inverse Scattering Theory and Transmission Eigenvalues*, coauthored with David



Colton and Houssem Haddar, the second edition of which has recently appeared in the National Science Foundation–Conference Boards of the Mathematical Sciences (NSF-CBMS)–the NSF-CBMS Regional Conference Series in Applied Mathematics published by SIAM.

Biographical Sketch. Fioralba Cakoni is a Distinguished Professor of Mathematics at Rutgers University, New Brunswick, where she has been since 2015. Prior to joining Rutgers, she was a postdoctoral Alexander von Humboldt Research Fellow at the University of Stuttgart, Germany, and later a faculty member in the Department of Mathematical Sciences at the University of Delaware. She has also held visiting research positions at École Polytechnique and École Nationale Supérieure de Technique Avancées (ENSTA) in Paris. Professor Cakoni was named a Simons Fellow in Mathematics in 2016, elected a Fellow of the American Mathematical Society in 2019, and a Fellow of the Society for Industrial and Applied Mathematics in 2023. Professor Cakoni works in inverse scattering for inhomogeneous media, noniterative reconstruction methods, spectral methods in inverse scattering, and inverse problems for partial differential equations. She has coauthored more than 120 research articles and three monographs and her work has had a significant impact on the fields of inverse scattering and inverse problems.

The Kovalevsky Lecture honors Sonia Kovalevsky (1850–1891), the most widely known Russian mathematician of the late-nineteenth century. In 1874, Kovalevsky received her Doctor of Philosophy degree from the University of Göttingen and was appointed lecturer at the University of Stockholm in 1883. Kovalevsky did her most important work in the theory of partial differential equations.

Association for Women in Mathematics
P.O. Box 40876, Providence, RI 02940
401.455.4042 • awm@awm-math.org • www.awm-math.org

21 shkurt, Dita Ndërkombëtare e Gjuhës Amtare



Sot është Dita Ndërkombëtare e Gjuhës Amtare, e shpallur si e tillë nga UNESCO (Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë), e miratuar më 21 shkurt 1999 nga Asambleja e Kombeve të Bashkuara me një rezolutë të veçantë.

Në këtë ditë të gjuhës amtare, ne përkujtojmë të gjithë ata që luftuan në shekuj, e sidomos rilindësit e shquar që punuan e luftuan për kombin shqiptar, për gjuhën shqipe e për ta shkruar atë me një alfabet të vetëm. Kongresi i Manastirit në vitin 1908, i njohur edhe si kongresi i alfabetit, ishte kongresi i bashkimit tonë kombëtar dhe faktori gjuhësor luajti rol parësor në procesin e gjatë të bashkimit.

Në vitin 1912 u shpall Pavarësia, populli shqiptar krijoi shtetin e vet dhe shqipja u bë gjuha zyrtare e këtij shteti. Por fatkeqësisht vetëm 6 muaj më vonë, në qershor të vitit 1913, trojet shqiptare u copëtuan në disa shtete, por kjo ndarje nuk çoi në shpërbërjen e kombit tonë. Populli e ruajti njësimin kombëtar. Gjithashtu, roli i gjuhës amtare shqipe si mjet identifikimi dhe bashkimi ka qenë i jashtëzakonshëm në rrugëtimin e shqiptarëve në shekullin XX.

Në vitin 1972, u bë Kongresi i Drejtshkrimit, i njohur si kongresi i dytë i bashkimit kombëtar, sepse mbi copëtimin në disa shtete të shqiptarëve u ngrit harta e

gjuhës së vetme të njësuar ose e gjuhës shqipe të standardizuar, e pranuar nga shqiptarët e të gjitha trojeve. Shqipja jonë amtare, si mjet identifikimi e bashkimi kombëtar, tani fitoi një përmasë të re, edhe atë unifikuese.

Këtë vit Akademia e Shkencave e Shqipërisë ka hapur zyrtarisht për publikun platformën online <https://www.fjalori.online> të "Fjalorit të madh të gjuhës shqipe", duke ofruar qasje të lirë për të gjithë përdoruesit në domenin fjalori.online, me vendimin nr. 1, datë 06.01.2026. Faqja është bërë funksionale nga data 12.01.2026.

“Fjalori i madh i gjuhës shqipe” shënon kurorëzimin e punës 5-vjeçare (2021-2025) dhe pasqyron mbi 125.000 njësi leksikografike (rreth 105.000 fjalë në zëra të veçantë, rreth 3.500 fjalë “të fshehura” në kuptime si emra, mbiemra a ndajfolje, rreth 12.500 njësi frazeologjike, rreth 5.000 togfjalësha terminologjike, rreth 1.200 emërtime shkurtesore, rreth 250 terma të huazuar të paasimiluar grafikisht, rreth 1.650 shprehje të huaja të paasimiluara e rreth 250.000 kuptime leksikore me mbi 1.000.000 shembuj ilustrues për këto kuptime etj.. Ai vjen para përdoruesit të gjuhës shqipe si vepra leksikografike prej kohësh e munguar dhe mjaft e kërkuar.

In memoriam

Përkujtojmë sot, në përvjetorin e ndarjes nga jeta, rilindësin Jeronim de Rada



Rilindësi, studiuesi i trashëgimisë kulturore të arbëreshëve, gazetari, poeti, publicisti, filologu e mësuesi, themeluesi i letërsisë arbëreshe Jeronim de Rada ndërroi jetë më 28 shkurt të vitit 1903.

Jeronim de Rada lindi më 19 nëntor 1814 në fshatin e vogël dhe piktoresk Maki në Kalabri. Në Napolin e vitit 1834, De Rada, një i ri rreth të 20-tave që studionte drejtësi, e ndiente nga larg Shqipërinë. Në mësimet e para që mori në kolegjin e Shën Adrianit të Shën Mitër Koronës apo leximet e para shqip, ai e ndiente veten më shumë të lidhur me

të shkuarën kombëtare shqiptare.

De Rada ishte nismëtari i letërsisë moderne shqiptare. “Botimi i Këngëve të Milosaos” në vitin 1836, jo vetëm që shënoi fillimin e një faze të re në letërsinë shqipe, por i hapi shtegun europianizmit që do të karakterizojë veprat e autorëve të mëvonshëm.

Në vitet 1847-1848, De Rada botoi “Rrëfimet e arbit”, që përmblihte katër novela në vargje, ku ideja patriotike shprehej me lirizëm të theksuar. Në drejtimin e kësaj figure qendrore të periudhës së Rilindjes u botua në Napoli gazeta e parë në historinë e shtypit shqiptar, “L’albanese d’Italia”. Ai ngriti përmes penës së tij çështjen shqiptare.

Nga viti 1861, De Rada nisi një fazë e re, ku shfaqet si një nga figurat më në zë të Rilindjes Kombëtare të shqiptarëve. Pas traktatit “Parimet e estetikës” (Principii di estetica, 1861) ai botoi veprat “Lashtësia e kombit shqiptar” (“Antichità della nazione albanese”, 1864) dhe “Rapsodi të një poeme arbëreshe” (“Rapsodie d’un poema albanese”, 1866), që luajtën një rol të rëndësishëm për propagandimin e çështjes kombëtare.

Në vitet 1890, De Rada përfundoi poemat “Skënderbeu i pafan” (që konsiderohet një nga veprat më të mira) dhe “Gjon Huniadi”.

Më 1878-n De Rada përkrahu Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe ngriti zërin kundër gjymtimit tokësor të Shqipërisë. Ai i dha një ndihmesë të çmuar çështjes kombëtare me revistën “Flamuri Arbit”, që e botoi në vitet 1883-1885.

De Rada është nga të parët studiues të strukturës gramatikore të shqipes. Në të dyja veprat gramatikore që hartoi (1870, 1894) vuri në dukje aspekte të patheksuara më parë nga dijetarë shqiptarë dhe albanologë dhe dukuri gjuhësore të pastudiuara ose të panjohura. Në veprat e tij gjuhësore jepen të dhëna me interes për të folmet arbëreshe. Bëri përpjekje të vijueshme për një alfabet të përbashkët të shqipes që të jepte një sistem sa më të plotë dhe të përshtatshëm për shqipen me karaktere latine.

Në veprimtarinë gjuhësore të De Radës duhet përmendur edhe organizimi i dy kongreseve gjuhësore të shqipes, i pari (1895) në Koriliano Kalabro të Provincës së Kozencës, i dyti (1897) në Lungro, provincë e Kalabrisë.

De Rada luajti një rol të madh në historinë e letërsisë shqiptare. Në Itali janë botuar tashmë mbi 10 vëllime të veprës së De Radës që përfshijnë jo vetëm krijimtarinë poetike, por edhe atë gjuhësore, politiko-filozofike, letërkëmbimin etj.

Studiuesi i veprës së tij akad. Matteo Mandalà shkruan se “De Rada ishte një idhull për të rinjtë e kohës. Nismëtar dhe organizues tubimesh shkencore dhe kulturore, nxitës botimesh që përndryshe do t’i kishim humbur, mbledhës i palodhur dhe studiues i këngëve popullore, De Rada ishte një vizionar i madh që arriti të parashikonte historinë e aspiratave të Shqipërisë si askush tjetër”

Akademia e Shkencave përkujton në ditën e saj të lindjes arkeologen dr. Hëna Spahiu



Arkeologia e shquar dr. Hëna Spahiu lindi më 26 shkurt 1933. Pasi kreu shkollën e mesme në Tiranë, vazhdoi studimet e larta në Universitetin e Budapestit, ku dhe u diplomua në fushën e arkeologjisë, duke pasur si udhëheqës profesorin e shquar hungarez Lazio Gjulia, specialist i mirënjohur i arkeologjisë së periudhës “së dyndjes së madhe të popujve”. Ajo mbrojti diplomën me temën “Kultura e Komanit”, e cila mbeti edhe më pas në qendër të vëmendjes së kërkimeve e studimeve të saj. Lidhur me këtë temë, ende si studente, kishte vizituar varrezën pranë Kalasë së Dalmacës (Koman) dhe kishte marrë pjesë në gërmimet hetimore që nisën më 1956-n në një varrezë tjetër arbërore pranë Krujës. Këto gërmime i vazhdoi si bashkautore edhe në vitet që pasuan. Me pasionin e një arkeologeje gjithnjë të re, ajo punoi për rreth 30 vite në kantiere të ndryshme arkeologjike.

Dr. Hëna Spahiu dha një ndihmesë të çmuar, fillimisht me një numër studimesh e më vonë në disertacionin “Varreza arbërore e Kalasë së Dalmacës” të mbrojtur prej saj më 1982-shin, me të cilin fitoi gradën "Doktoreshë e shkencave". Studimet e tjera të saj dëshmojnë për një përkushtim të posaçëm për kërkimet në një fushë të re të arkeologjisë shqiptare, siç ishte ajo e periudhës së mesjetës. Është i njohur tashmë studimi

monografik i saj me bashkautor D. Komatën, kushtuar rezultateve të gërmimeve 4-vjeçare (1967-'70) në Shurdhah-Sarda, një qytet i fortifikuar mesjetar shqiptar. Vepra e dytë monografike e saj është "Qyteti i fortifikuar i Beratit", të cilën nuk e pa të botuar. Hëna Spahiu punoi edhe në fushën e numizmatikës bizantine, duke hartuar katalogun e parë të monedhave bizantine të gjetura në Shqipëri. Është gjithashtu bashkautore e një albumi ilustrativ për stolitë arbërore.

Disa fushata gërmimesh, me mjete të kufizuara e vështirësi të kohës, i dhanë asaj një lëndë të pasur arkeologjike, që do të përbënte një bazë të fuqishme për një punim madhor për kulturën arbërore, për të cilin kishte filluar punën përgatitore, por që ndarja nga jeta ia ndërpreu në mes.

Veprimtaria shkencore e dr. Hëna Spahiut është manifestuar edhe në pjesëmarrjen në dy kuvendet e studimeve ilire dhe në veprimtari të tjera shkencore brenda dhe jashtë vendit.

U nda nga jeta në vitin 1993. Vdekja e parakohshme la pa realizuar edhe plane të tjera premtuese në fushën e arkeologjinë mesjetare shqiptare. Për vlerën e punës shkencore që la pas, emri i Hëna Spahiut do të kujtohet gjithnjë me respekt të veçantë.